



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6089/8
Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 23.12.2025

URDHËR

Nr. 614, datë 23.12.2025

PËR

MIRATIMIN E “STANDARDEVE PËR TEKSTET SHKOLLORE, TË
RISHIKUARA”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 47 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 1, të kreut VI të udhëzimit nr. 26, datë 17.11.2025 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të konkurrimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe përditësimit të teksteve shkollore dhe përmbajtjeve digjitale, si dhe miratimit të katalogut zyrtar të teksteve shkollore në sistemin arsimor parauniversitar”, të shkronjave “d” dhe “dh”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe të urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Standardeve për tekstet shkollore, të rishikuara”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Urdhri nr. 155, datë 22.04.2015 “Për miratimin e standardeve për tekstet shkollore”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



SHTOJCA 1



STANDARDET PËR TEKSTET SHKOLLORE

TË RISHIKUARA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

STANDARDET PËR TEKSTET SHKOLLORE

TË RISHIKUARA

2025

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
QËLLIMI DHE FUNKSIONET E STANDARDEVE PËR TEKSTET SHKOLLORE.....	5
KONTEKSTI I RI KURRIKULAR I STSH-VE.....	6
LLOJET, TREGUESIT, PËRSHKRUESIT DHE VLERA E STANDARDEVE	8
STANDARDI I PËRPUTHSHMËRISË ME KUADRIN LIGJOR DHE ETIK, SI DHE STANDARDI TEKNIK	8
STANDARDET E PËRGJITHSHME.....	8
STANDARDET LËNDORE.....	8
TREGUESI I STANDARDIT	9
PËRSHKRUESI I PËRMBUSHJES	9
VLERA E PËRSHKRUESIT.....	10
VLERA E STANDARDIT. LLOGARITJA E SAJ.....	10
VLERA E TEKSTIT. LLOGARITJA E SAJ	11
RENDITJA E TEKSTIT SHKOLLOR	11
OBJEKTIVITETI GJATË VLERËSIMIT TË TEKSTIT SHKOLLOR	12
PJESA I	13
STANDARDET E PRANIMIT TË TEKSTIT SHKOLLOR NË KONKURS	13
Standardi: Përputhshmëria me kuadrin ligjor dhe etik	13
Standardi: Krite teknike të tekstit shkollor	13
PJESA II	15
STANDARDE TË PËRGJITHSHME	15
A. Përputhshmëria ME KURRIKULËN, FORMATIMI, PARAQITJA (Standardet 1-3)	15
Standardi 2: Kompozimi/projektimi grafik, faqosja e tekstit	15
Standardi 3: Ilustrimet	16
B. ÇËSHTJE SHKENCORE DHE DIDAKTIKE (Standardet 4-8)	17
Standardi 4: Cilësia në lidhje me përmbajtjen e lëndës, rëndësinë dhe aktualitetin.....	17
Standardi 5: Përshtatja me moshën dhe me nevojat e nxënësve	17
Standardi 6: Konceptimi dhe shtjellimet didaktike.....	18
Standardi 7: Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat.....	19
Standardi 8: Aspektet gjuhësore.....	20
C. ÇËSHTJE PEDAGOGJIKE (Standardet 9-12).....	21
Standardi 9: Lidhja me realitetet politike, historike dhe shoqërore	21
Standardi 10: Çështjet edukative, pavarësia, edukimi për demokraci dhe paqe.....	22
Standardi 11: Pasqyrimi i barazisë gjinore në tekstin shkollor	22
Standardi 12: Integrimi ndërlëndor dhe i temave ndërkurrikulare	23

D. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME PRAKTIKËN SHKOLLORE (Standardet 13-14)	24
Standardi 13: Teksti i mësuesit dhe përdorimi i tij.....	24
Standardi 14: Materialet që shoqërojnë tekstin shkollor	25
PJESA III	27
STANDARDET LËNDORE	27
15.1 GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	27
15.1.1 Abetarja.....	27
15.1.2 Gjuha shqipe për shkollën 9-vjeçare; Gjuha amtare për pakicat kombëtare; Gjuha shqipe dhe Letërsia për arsimin e mesëm të lartë.	28
15.1.3. Gjuhët e huaja	30
15.1.4. Gjuha shqipe për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë.....	32
STANDARDI 15.2. MATEMATIKA	34
STANDARDI 15.3. SHKENCAT E NATYRËS	37
Standardi 15.3.1Dituri natyre	37
Standardi 15.3.2 Fizika	39
Standardi 15.3.3 Kimia	41
Standardi 15.3.4Biologjia	43
STANDARDI 15.4. SHKENCAT SHOQËRORE.....	46
15.4.1 Historia	46
15.4.2 Qytetaria.....	48
15.4.3 Gjeografia	49
15.4.4 Shkencat e tjera sociale dhe filozofia	51
STANDARDI 15.5. ARTET	54
15.5.1 Muzika	54
15.5.2 Arti pamor	55
15.5.3 Teatri (AML)	57
15.6. TEKNOLOGJI DHE TIK.....	59
15.6.1 Aftësimi teknologjik praktik.....	59
15.6.2 TIK	60
15.6.3 Bazat e inxhinierisë dhe Teknologjia (AML).....	62
STANDARDET E PËRMBAJTJES DIGJITALE.....	64
Standardi 1: Funkzionet dhe cilësia e përmbajtjes digjitale.....	64
Standardi 2: Aspektet gjuhësore të përmbajtjes digjitale	65
Shtojca:	67
BIBLIOGRAFIA	70

HYRJE

QËLLIMI DHE FUNKSIONET E STANDARDEVE TË TEKSTEVE SHKOLLORE

Teksti shkollor është një mjet i rëndësishëm arsimor dhe edukativ, i cili kryen disa funksione, si:

- Organizimi dhe zhvillimi i përmbajtjes mësimore, në mënyrë që nxënësit të ndërtojnë dhe të demonstrojnë njohuri të reja, si dhe të zhvillojnë kompetencat për të nxënëit gjatë gjithë jetës.
- Sigurimi i të nxënëit aktiv, duke ndihmuar nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur me tekstin, të interpretojnë informacionin dhe ta lidhin atë me njohuritë e mëparshme.
- Zhvillimi i mendimit kritik, zgjidhjes së problemeve, krijimtarisë dhe aftësisë së nxënësve për të zbatuar njohuritë në situata reale.
- Mbështetja e procesit të vlerësimit dhe vetëvlerësimit, përmes pyetjeve, ushtrimeve reflektuese dhe detyrave që i ndihmojnë nxënësit të matin arritjet e tyre.

Në Standardet për Tekstet Shkollore (STSH) përcaktohen kritere dhe aspekte që duhet të plotësojë çdo tekst shkollor, për të mbështetur arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar, si: zhvillimin e identitetit personal dhe kombëtar, si dhe të përkatësisë kulturore; përvetësimin e vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare; zhvillimin intelektual, etik, fizik, social dhe estetik; nxitjen e përgjegjësisë ndaj vetes, të tjerëve, shoqërisë dhe mjedisit; aftësimin për jetën dhe për punën në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; aftësimin për të nxënë gjatë gjithë jetës; zhvillimin e shpirtit sipërmarrës dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore.

I vendosur në këtë kontekst, dokumenti i STSH-ve, i përditësuar, vlen si instrument normativ praktik për specialistët e arsimit dhe mësuesit, për shtëpitë botuese të teksteve shkollore, për autorët, për vlerësuesit dhe për komisionet e vlerësimit të teksteve shkollore. Ai ofron kriteret kryesore për vlerësimin e teksteve shkollore dhe një metodologji vlerësimi praktike dhe të zbatueshme.

Dokumenti u shërben përdoruesve të tij për të realizuar vlerësime të njësuara të teksteve shkollore, bazuar në kritere të përcaktuara dhe të pranuara, veçanërisht:

- **Për hartimin e teksteve të reja**, duke udhëzuar autorët dhe botuesit mbi aspektet dhe treguesit që duhet të përmbushin;
- **Për vlerësimin, miratimin dhe certifikimin e teksteve të reja**, duke ofruar një kuadër të përbashkët referimi për institucionet dhe komisionet e vlerësimit;
- **Për vlerësimin e teksteve ekzistuese**, duke ndihmuar në identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim dhe në unifikimin e procesit të vlerësimit.

Hartimi i këtyre standardeve është mbështetur gjithashtu edhe mbi parimet e Dizajnit Universal për të Nxënit¹ (UDL). UDL është një qasje bashkëkohore që synon të krijojë materiale mësimore gjithëpërfshirëse dhe fleksibël, të aksesueshme për të gjithë nxënësit. UDL bazohet në tri parime kryesore:

- Mënyra të ndryshme prezantimi të informacionit mësimor (tekst, pamje, foto, multimedia, burime ndërvepruese).
- Mënyra të ndryshme angazhimi për të nxitur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- Mënyra të ndryshme shprehjeje dhe demonstrimi të njohurive, duke respektuar stilet e të nxënit dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve

KONTEKSTI I RI KURRIKULAR I STSH-VE

Standardet për Tekstet Shkollore (STSH) mbështeten në parimet dhe në orientimet e paketës së re kurrikulare të arsimit parauniversitar, e cila përfshin Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar, kurrikulat bërthamë, planet mësimore dhe programet lëndore të përditësuara. Kjo paketë përcakton drejtimit kryesore të zhvillimit të arsimit parauniversitar, udhëzon veprimtarinë e stafit mësimor të shkollave dhe përkrahur njohuritë dhe kompetencat kyç që u nevojiten nxënësve sot dhe në të ardhmen.

Paketa kurrikulare është konceptuar për të mundësuar zhvendosje të reja në qasjen mësimore dhe organizimin e të nxënit:

- nga kurrikula e përqendruar te memorizimi i njohurive, te kurrikula e bazuar në kompetenca;
- nga mësimdhënia e përqendruar te mësuesi, te mësimdhënia e përqendruar te nxënësi;
- nga shpjegimi i mësuesit te metodologjitë ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Paketa kurrikulare vendos themelet e një “kontrate morale” mes institucioneve arsimore dhe shoqërisë, veçanërisht me prindërit dhe me nxënësit. Në përputhje me misionin e ri të shkollës (arsimim, socializim dhe kualifikim) kurrikula e përditësuar materializon qasjen e bazuar në kompetenca, duke përfshirë të gjitha dimensionet e zhvillimit të nxënësve dhe duke pasqyruar vizionin arsimor të shoqërisë shqiptare dhe pritshmëritë për nxënësit.

Kjo qasje:

- mundëson ndërtimin dhe demonstrimin e kompetencave nga nxënësit;
- integron lëndët mësimore në një tërësi koherente, të përqendruar në situata reale të jetës;
- nxit të nxënit ndërkurrikular që tejkalon kufijtë mes disiplinave dhe lëndëve mësimore;
- kërkon ekspertizë profesionale nga mësuesit, duke u dhënë hapësirë për zgjedhje individuale dhe kolektive;
- siguron mundësi të barabarta suksesi për të gjithë nxënësit, duke respektuar stilet personale të të nxënit dhe përvojat e tyre të mëparshme.

E kuptuar në tërësi, kurrikula e re integron një grup lëndësh mësimore^[2] (dhe tekstet shkollore përkatëse), si pjesë e *burimeve të jashtme* që përdoren gjatë nxënies. Lëndët

¹ Universal Design for Learning


² Në këtë dokument, lënda mësimore nënkupton dijet, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet të cilat janë objekt i të nxënit të një aspekti/fushe të caktuar.

organizohen në shtatë fusha të nxëni (gjuhët dhe komunikimi, matematika, shkencat e natyrës, shkencat shoqërore, artet, teknologjia dhe TIK-u, edukimi fizik, sportet dhe shëndeti), që grupojnë lëndë të lidhura ose me fokuse të përbashkëta. Fushat e të nxënit përfshijnë aspekte shoqërore dhe kulturore që u mundësojnë nxënësve të zhvillojnë kombinime të kompetencave (kapacitete vetjake që integrojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime, përmes të cilave individit trajton në mënyrë efektive situatat), duke i aftësuar ata të marrin pjesë në evolucionin shoqëror dhe kulturor të botës së tyre. Burimet e jashtme dhe *burimet e brendshme* (gjithë sa personi aktivizon si njohuri, aftësi, qëndrime, motive, emocione etj.), janë mjete që përdor dhe/ose nxit mësuesi për të ndihmuar nxënësin të ndërtojë kompetencat (kyç dhe lëndore).

Kompetencat ndërtohen/përsosen gjatë ndërveprimeve të nxënësit në situata të ndryshme që ofrohen nga teksti shkollor, nga mjedisi i të nxënit dhe nga kontekste dhe çështje më të gjera jetësore, të cilat kurrikula e re i përcakton si *tema ndërkurrikulare*. Në këtë kontekst, realizohet veprimtaria e shkollës për t'u mundësuar nxënësve të zhvillojnë njohuri të reja dhe kompetenca, në funksion të qëllimeve të arsimit parauniversitar.

Parimet, orientimet dhe kërkesat e paketës së re kurrikulare përbëjnë kornizën konceptuale mbi të cilën bazohen Standardet për Tekstet Shkollore.

PROGRAMI LËNDOR



LLOJET, TREGUESIT, PËRSHKRUESIT DHE VLERA E STANDARDEVE

Në këtë dokument, për vlerësimin e çdo teksti shkollor përdoren standardet e grupuara si më poshtë:

- Standardi i përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe etik.
- Standardet e përgjithshme.
- Standardet lëndore.
- Standardi teknik.
- Standardet e përmbajtjes digjitale.

STANDARDI I PËRPUTHSHMËRISË ME KUADRIN LIGJOR DHE ETIK, SI DHE STANDARDI TEKNIK

- *Standardi i përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe etik* përcakton kërkesat kryesore për etikën dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor. Ky standard është pjesë e paketës së vlerësimit së bashku me standardet e përgjithshme dhe standardin lëndor.
- *Standardi teknik* përcakton kriteret teknike dhe formale që duhet të përmbushë teksti, si cilësia e shtypit, formatimi, struktura, elementet grafike dhe aspektet fizike të botimit. Ky standard vlerësohet nga një ekspert në fushën e botimeve, pas shpalljes së renditjes paraprake të teksteve. Në rastet kur teksti nuk i përmbush kriteret teknike, hiqet nga renditja e teksteve shkollore fituese.

Këto dy standarde janë të vlefshme për të gjitha tekstet shkollore dhe përcaktojnë kushtet paraprake dhe kriteret teknike që duhet të përmbushë një tekst shkollor. Mospërmbushja e cilitdo prej treguesve të këtyre standardeve e përjashton automatikisht tekstin nga e drejta për të fituar dhe për t'u certifikuar.

STANDARDET E PËRGJITHSHME

Ky grup standardesh, i vlefshëm për vlerësimin e të gjitha teksteve shkollore, është i organizuar në katër fusha:

- A. Përputhshmëria me kurrikulën, formatimi, paraqitja (standardet 1-3).
- B. Çështje shkencore dhe didaktike (standardet 4-8).
- C. Çështje pedagogjike (standardet 9-12).
- D. Çështje që lidhen me praktikën pedagogjike (standardet 13-14).

STANDARDET LËNDORE

Standardet lëndore paraqesin kërkesa specifike që çdo tekst shkollor duhet të plotësojë në varësi të lëndës që mbulon. Ato specifikojnë elementet përmbajtësore, metodologjike dhe gjuhësore të lidhura drejtpërdrejt me qëllimet, natyrën dhe veçantitë e çdo lënde mësimore. Standardet lëndore në këtë dokument janë grupuar dhe renditur sipas fushave të të nxënit.

Vlerësimi i çdo standardi lëndor realizohet nëpërmjet treguesve që matin përputhjen e përmbajtjes së tekstit me qëllimet e lëndës dhe treguesve që matin sa gjithëpërfshirës është

teksti, si dhe sa ofron mënyra të ndryshme prezantimi, angazhimi dhe shprehjeje për nxënësit me stile, aftësi dhe nevoja të ndryshme.

STANDARDET E PËRMBAJTJES DIGJITALE

Në kuadër të modernizimit të teksteve shkollore dhe të përafrimit me praktikat bashkëkohore të mësimdhënies, në këtë dokument të standardeve është përfshirë edhe një seksion i veçantë për *standartet e përmbajtjes digjitale*. Ky seksion përcakton kriteret që duhet të plotësojë përmbajtja digjitale që shoqëron tekstin shkollor, duke garantuar cilësi, funksionim teknik, aksesueshmëri dhe përputhshmëri me tekstin shkollor përkatës.

Standardet e përmbajtjes digjitale përfshijnë:

- Funksionet dhe cilësia e përmbajtjes digjitale
- Aspektet gjuhësore të përmbajtjes digjitale

Përmbajtja digjitale është pjesë integrale e tekstit shkollor dhe synon të mbështesë mësimdhënien e bazuar në kompetenca, të nxisë ndërveprimin, personalizimin e të nxënit dhe gjithëpërfshirjen, në përputhje me parimet e Dizajnit Universal për të Nxënit (UDL). Standardet e paraqitura në këtë seksion udhëheqin autorët, botuesit dhe vlerësuesit në sigurimin e materialeve digjitale cilësore, të organizuara, të kuptueshme dhe të dobishme për mësuesit dhe nxënësit në klasë dhe në mësimin në distancë.

Standardet e përmbajtjes digjitale përdoren vetëm në rastet kur teksti shkollor shoqërohet me përmbajtje digjitale. Kriteret dhe nivelet e vlerësimit janë të njëjta me ato teksteve shkollore fizike. Vlerësimi i standardeve të përmbajtjes digjitale realizohet vetëm për tekstet fituese pas shpalljes së renditjes paraprake të teksteve të reja shkollore. Përmbajtja digjitale duhet të jetë në përputhje me tekstin shkollor përkatës.

TREGUESI I STANDARDIT

Çdo standard detajohet përmes treguesve të tij. Treguesit paraqesin aspekte të veçanta, konkrete dhe sa më të zbatueshme, nëpërmjet të cilave mund të vlerësohet se në çfarë shkalle është përmbushur standardi. Shkalla e përmbushjes së këtyre elementeve shprehet përmes përshkruesve të përmbushjes.

PËRSHKRUESI I PËRMBUSHJES

Përshkruesi i përmbushjes tregon se në ç' shkallë/ nivel aspektet e treguesit/standardit përmbushen nga teksti shkollor. Meqenëse kërkesat e treguesit mund të përmbushen në masa të ndryshme, përdoren këta përshkrues:

PËRSHKRUESI	KUPTIMI I PËRSHKRUESIT
Nuk përmbushen	Teksti paraqet mangësi në lidhje me treguesin, nuk reflekton qëllimin e tij dhe nuk përmban aspekte ose përmbajtje që tregojnë përmbushjen e tij. Në këtë nivel, është i nevojshëm rishikim i plotë i përmbajtjes së treguesit.
Përmbushen pjesërisht	Teksti përfshin pak aspekte që lidhen me treguesin, por këto janë të pamjaftueshme ose të paplota. Përmbajtja tregon përpjekje minimale

	për ta adresuar treguesin, por nuk arrin nivelin e kërkuar. Nevojiten përmirësime në cilësi dhe në qartësi.
Përbushen mjaftueshëm	Vetëm disa prej aspekteve të treguesit përkatës përbushen nga teksti shkollor, megjithatë, ka nevojë të konsiderueshme për plotësim dhe përmirësim të përmbajtjes, për të arritur nivelin e plotë.
Përbushen mirë	Aspektet e treguesit përkatës janë përbushur mirë nga teksti shkollor, por disa përmirësime janë të mundshme. Teksti është i strukturuar mirë, i qartë dhe lidhet drejtpërdrejt me qëllimin e treguesit. Ka disa elemente që mund të pasurohen ose thellohen më tej, por në përgjithësi përmbajtja plotëson kërkesat dhe i afrohet nivelit maksimal të përbushjes.
Përbushen shumë mirë	Aspektet e treguesit përkatës janë përbushur plotësisht nga teksti shkollor. Teksti ofron qartësi, koherencë, logjikë të brendshme dhe trajtim të thelluar të përmbajtjes. Nuk vërehen mangësi të rëndësishme dhe përputhshmëria me treguesin është e plotë. Ky nivel përfaqëson nivel të lartë të përbushjes.

Dallimet ndërmjet niveleve/përmasave të përbushjes së aspekteve të treguesve nga teksti shkollor i shpreh *vlera e përshkruesit të përbushjes*.

VLERA E PËRSHKRUESIT

Vlera e përshkruesit të përbushjes së treguesit/standardit shpreh se deri në ç' masë përbushen aspektet e treguesit/standardit nga teksti shkollor. Në dokumentin e STSH-ve, vlerat e përshkruesve shprehen me një nga numrat 0-4. Lidhja ndërmjet përshkruesve dhe vlerave përkatëse paraqitet në tabelë:

PËRSHKRUESI	VLERA
Nuk përbushen	0
Përbushen pjesërisht	1
Përbushen mjaftueshëm	2
Përbushen mirë	3
Përbushen shumë mirë	4

Me ndihmën e përshkruesve dhe të vlerave të tyre llogaritet vlera e standardit.

VLERA E STANDARDIT. LLOGARITJA E SAJ

Lidhja e përshkruesve me vlerat përkatëse lejon që, me ndihmën e një formule të thjeshtë, të caktohet *vlera e standardit*, si në vijim:

- Për secilin tregues të standardit, sipas nivelit të përbushjes së aspekteve nga teksti shkollor, identifikohet vlera e përshkruesit me simbolin X, në kutinë përkatëse.
- Vlerat e të gjithë përshkruesve mbledhen dhe shuma pjesëtohet me numrin e treguesve.
- Rezultati i përfutur përbën vlerën e standardit dhe shënohet me një numër me dy shifra pas presjes dhjetore.

- Vlerësimi i çdo standardi duhet të shoqërohet me një argumentim të qartë nga vlerësuesi, i cili shpjegon pse është dhënë ajo vlerë përfundimtare, duke u mbështetur në të dhënat nga treguesit përkatës.
- Për tekstet fituese, vlera e çdo standardi duhet të jetë më e madhe se 2.5.

ILUSTRIM

Standardi 1: Përputhshmëria me dokumentet kryesore kurrikulare dhe me tekstet shkollore të klasave paraardhëse dhe pasuese të së njëjtës lëndë.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1.	Teksti shkollor përputhet me parimet e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, e përditësuar.				X	
1.2.	Teksti shkollor krijon mundësi për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç të shekullit XXI, për të nxënëit gjatë gjithë jetës.			X		
1.3.	Përmbajtja dhe mënyra e trajtimit të temave mësimore në tekst përputhen me kërkesat specifike të programit mësimor të lëndës dhe të klasës përkatëse.					X
1.4.	Teksti shkollor është në koherencë dhe vazhdimësi me tekstet e së njëjtës lëndë në klasat pararendëse dhe pasuese, duke siguruar që terminologjia dhe qasja e të nxënëit të jenë në përputhje dhe të respektohet thellimi gradual i përmbajtjes mësimore në nivele më komplekse. ³				X	
Shuma e vlerave të treguesve (1.1 + 1.2 + 1.3+1.4) = 3 + 2 + 4 +3 = 12 Vlera e standardit 1 = 12 : 4 = 3 (I përmbushur "Mirë")						

VLERA E TEKSTIT. LLOGARITJA E SAJ

Vlera e tekstit shkollor quhet mesatarja aritmetike e vlerave të 14 standardevë të përgjithshme dhe e vlerës së standardit lëndor.

RENDITJA E TEKSTIT SHKOLLOR

Që teksti shkollor i pranuar në konkurs të përzgjidhet për t'u renditur, duhet të përmbushë standardin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe etik, si dhe standardin teknik.

Tekstet shkollore të reja për çdo lëndë dhe klasë renditen sipas madhësisë së vlerave të tyre.

- Në rast barazimi të vlerave, përparësi merr teksti që ka vlerën më të madhe të standardit lëndor.
- Nëse vlerat mbeten të barabarta, renditja përcaktohet nga çmimi i propozuar nga botuesi dhe/ose distributori (teksti me çmim më të ulët renditet më lart).
- Nëse edhe pas këtij hapi vlerat janë të njëjta, renditja përcaktohet me short.

³ Nëse nuk ekziston paketa e plotë e të gjithë programeve, ky tregues nuk do të vlerësohet. Vlera e standardit do të llogaritet me aq tregues sa janë realisht të vlerësuar.

Vlera e tekstit fitues duhet të jetë më madhe se 2.5. I njëjti prag duhet të zbatohet edhe për vlerën e çdo standardi.

OBJEKTIVITETI GJATË VLERËSIMIT TË TEKSTIT SHKOLLOR

Përfundime dhe rezultate objektive të paraqitura me numra mund të arrihen vetëm për një numër të kufizuar treguesish (të tillë, p.sh., janë treguesit që lidhen me përdorimin e termave sa u përket gjinive, prania e barabartë e vajzave dhe e djemve në ilustrime etj.). Në shumë raste, nuk mund mënjanohet tërësisht aspekti subjektiv sepse, karakteristika si “përshtatshmëria me moshën e nxënësve” ose “cilësia e ilustrimeve” etj., për të cilat nuk ka përcaktime të standardizuara, interpretohen nga çdo vlerësues në mënyrë vetjake.

Faktorë që ndihmojnë rritjen e objektivitetit

a) Vlerësimi i paanshëm dhe me ekspertizë të larmishme.

Teksti shkollor vlerësohet, në kushte anonimiteti të botuesit, nga të paktën pesë vlerësues të certifikuar, të pavarur dhe të kualifikuar:

- ✓ një pedagog/ekspert i lëndës përkatëse;
- ✓ dy mësues të lëndës sipas nivelit arsimor përkatës;
- ✓ një ekspert i standardit të gjuhës shqipe;
- ✓ një ekspert i fushës së botimeve (për standardin teknik).

b) Përdorimi i një spektri të gjerë treguesish.

Një listë prej rreth 100 treguesish siguron një pamje të detajuar dhe të diferencuar të tekstit shkollor, duke shmangur vlerësime të përgjithshme dhe sipërfaqësore.

c) Krahasimi i vlerave për disa tregues të njëjtë të çdo standardi. ⁴

⁴ Të krahasosh rezultatet (vlerat numerike) që kanë marrë disa tregues të njëjtë brenda secilit standard, për të parë nëse vlerësuesit i kanë vlerësuar në mënyrë të qëndrueshme dhe nëse ka ndonjë mospërputhje që kërkon sqarim.

PJESA I

STANDARDET E PRANIMIT TË TEKSTIT SHKOLLOR NË KONKURS

Standardi: Përputhshmëria me kuadrin ligjor dhe etik

Qëllimi: Që të renditet në konkurs, teksti shkollor NUK duhet të përmbajë asnjë aspekt/karakteristikë që bie ndesh me dispozitat e kuadrit ligjor dhe etik në Republikën e Shqipërisë.

Shënim: Teksti shkollor NUK kualifikohet, nëse konstatohet që në përmbajtjen dhe në përgatitjen e tij reflektohet qoftë dhe një nga treguesit e mëposhtëm.

Nr.	Treguesi	PO	JO
1.	Elemente të tekstit shkollor bien ndesh me Kushtetutën e Shqipërisë, Ligjin për arsimin parauniversitar dhe Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.		
2.	Në tekstin shkollor konstatohen pohime ose ilustrime bien në kundërshtim me kodin e etikës së shoqërisë.		
3.	Në tekstin shkollor konstatohen paragjykime sociale, etnike, racore, fetare, moshore, gjinore, gjeografike, si dhe elemente të frymës së urrejtjes dhe të nxitjes së armiqësisë për popujt e tjerë.		
4.	Teksti shkollor përmban reklama / promocione.		
5.	Teksti përdor materiale (tekste, ilustrime, foto) pa respektuar të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale, si dhe të papërditësuara me zhvillimet bashkëkohore.		
6.	Teksti shkollor përmban elemente që mund të identifikojnë përkatësinë e shtëpisë botuese dhe të autorëve.		

Standardi: Kritere teknike të tekstit shkollor

Qëllimi: Teksti shkollor të plotësojë kriteret teknike të përcaktuara për t'u renditur në tekstet fituese.

Shënim: Teksti shkollor NUK renditet fitues, kur nuk plotësohet qoftë dhe një nga treguesit e mëposhtëm.

NR	ELEMENTET E TEKSTIT SHKOLLOR	KRITERET	PO	JO
1	Organizimi i përmbajtjes së tekstit shkollor	Përmbajtja e tekstit shkollor paraqitet në një vëllim.		
2	Formati i prerë i tekstit shkollor	Klasat I – V: 207 mm gjatësi x 277 mm gjerësi		
		Klasat VI –XII: 180 mm gjatësi x 250 mm gjerësi		

3	Madhësia e germave	Klasat I-II: Shkronja me font mbi 14 Klasat III – IX: Shkronja me font mbi 12 Klasat X-XII: Shkronja me font mbi 11		
5	Hapësira mes rreshtave	Hapësira mes rreshtave: 120% e shkronjave		
6	Lloji i letrës për bllokun e librit dhe të fletores së punës (nëse ka)	Asnjë lloj letre me lustër		
		Opaciteti 80 për qind (ISO 2471)		
		Shkëlqimi 83 për qind (ISO 2470)		
		Pesha e letrës së librit 70 gsm		
		Pesha e letrës së fletores së punës (nëse ka) 70 gsm		
7	Lloji i letrës për kopertinën	Për libra deri 96 faqe 200 gsm		
		Për libra mbi 96 faqe 280 gsm		
8	Ngjyrat për bllokun e librit / të fletë punëve	Libri i nxënësit 4 ngjyra		
		Fletore pune e detyrueshme 2 ngjyra		
	Ngjyra për kopertinat	Kopertinat 4 ngjyra		
9	Lloji i lidhjes	Deri 96 faqe Me tel kaluar; 2 kapje		
		Mbi 96 faqe Ngjitje me hotmelt		
10	Elemente të detyrueshme të kopertinave	ISBN-ja		
		Barkod-i		
		Çmimi		
		Logo-ja e botuesit		
11	Qëndrueshmëria e tekstit shkollor	Cilësia e materialeve të përdorura për shtypjen e tekstit, përfshirë llojin e letrës, llojin e lidhjes së fletëve dhe mbrojtjen e kopertinës, është e tillë që garanton që libri të qëndrojë i paprekur dhe funksional gjatë gjithë vitit shkollor, edhe me përdorim të shpeshtë nga nxënësit.		

Rekomandime për hartuesit e tekstit shkollor

Sa i përket kompozimit të përmbajtjeve të tekstit shkollor, rekomandohet:
- Teksti shkollor të organizohet sipas kapitujve që fillojnë me faqen hyrëse ku gjenden përmbajtja e shkurtër, fjalët kyç, burimet e informacionit, përmbledhja e kapitullit.
- Të gjitha temat e kapitujve të fillojnë në faqe të re.
- Në faqet e tekstit shkollor, përveç shkrimeve themelore, mund të vendosen tabela, ilustrime, fragmente etj. Pozicioni i tyre, në aspektin pamor, të mos dëmtojë tërësinë e tekstit; sipas mundësisë, të pozicionohen në skajet e jashtëm të faqes.
- Për të gjithë titujt, të përdoret font i njëjtë për nga madhësia dhe nga lloji.
- Ilustrimet të shoqërohen me tekst me font me madhësi më të vogël se teksti kryesor.
- Numrat të jenë të nënvizuar dhe të veçuar nga teksti kryesor i faqes.

- | | |
|---|---|
| - | Fragmentet ku nxënësi duhet të ketë kujdes të posaçëm, të veçohen nga teksti kryesor. |
| - | Ana e përparme, ana e prapme dhe pjesa e shpinës së kopertinës të përbëjnë një tërësi pamore. |

PJESA II

STANDARDE TË PËRGJITHSHME

A. PËRPUTHSHMËRIA ME KURRIKULËN, FORMATIMI, PARAQITJA (STANDARDET 1-3)

Standardi 1: Përputhshmëria me dokumentet kryesore kurrikulare dhe me tekstet shkollore të klasave paraardhëse dhe pasuese të së njëjtës lëndë.

Qëllimet: *Teksti shkollor të zbatojë parimet e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, e përditësuar, dhe kërkesat specifike të programit të lëndës mësimore përkatëse. Ai duhet t'i ndihmojë nxënësit të ndërtojnë dhe të demonstrojnë njohuri dhe kompetenca, që të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja. Teksti shkollor, sa u përket filozofisë dhe mënyrës së të nxënies, të përputhet me tekstet shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese, duke garantuar vazhdimësinë dhe koherencën e kërkesave të programit mësimor.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1.	Teksti shkollor përputhet me parimet e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, e përditësuar.					
1.2.	Teksti shkollor krijon mundësi për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç të shekullit XXI, për të nxënësit gjatë gjithë jetës.					
1.3.	Përmbajtja dhe mënyra e trajtimit të temave mësimore në tekst përputhen me parimet dhe kërkesat specifike të programit mësimor të lëndës dhe të klasës përkatëse.					
1.4.	Teksti shkollor është në koherencë dhe vazhdimësi me tekstet e së njëjtës lëndë në klasat pararendëse dhe pasuese, duke siguruar që terminologjia dhe qasja e të nxënies të jenë në përputhje dhe të respektohet thellimi gradual i përmbajtjes mësimore në nivele më komplekse. ⁵					

Vlera e standardit 1 = $\{[1.1 + \dots + 1.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 2: Kompozimi/projektimi grafik, faqesja e tekstit

⁵ Nëse nuk ekziston paketa e plotë e të gjithë programeve lëndore dhe/ose e teksteve shkollore, ky tregues nuk do të vlerësohet. Vlera e standardit do të llogaritet me atë tregues sa vlerësohen.

Qëllimet: Teksti shkollor të ketë pamje tërheqëse, të jetë i strukturuar mirë dhe të lehtësojë orientimin e shpejtë të përdoruesit.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
2.1.	Teksti shkollor ka paraqitje të jashtme dhe të brendshme bashkëkohore dhe tërheqëse duke përfshirë kopertinën, kompozimin e faqeve, koherencën grafike me faqosjen, madhësinë e germave dhe hapësirën mes rreshtave.					
2.2.	Teksti shkollor ka strukturë të qartë dhe të kuptueshme, që lejon orientim të shpejtë dhe të lehtë (organizim logjik i kapitujve dhe temave, pasqyrë e lëndës, tituj dhe nëntituj të kuptueshëm, simbole orientuese etj.), si të përshtatshëm me moshën e nxënësve.					
2.3.	Çdo faqe është e faqosur mirë dhe pa mbingarkesë, me vendosje të përshtatshme të elementeve pamore (tabela, grafikë, harta, simbole, piktograme, ilustrime), që ndihmojnë orientimin dhe janë në përshtatje me moshën e nxënësve.					
2.4.	Burimet e materialeve (tekste, ilustrime, foto, harta, tabela) janë cituar saktë dhe plotësisht.					

Vlera e standardit 2 = $[2.1 + - + 2.4] : 4 = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 3: Ilustrimet

Qëllimet: Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktura, diagrame, tabela, grafikë, piktograme, kuti me komente shpjeguese) duhet të jenë të kuptueshme dhe me cilësi të lartë estetike e dokumentare; të mbështesin dhe të pasurojnë përmbajtjen mësimore; të përçojnë vlera morale e sociale të përshtatshme për moshën dhe programin lëndor; si dhe të nxisin ndërveprimin e nxënësve gjatë punës me tekstin. ^[6].

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
3.1.	Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktograme, diagrame, tabela, grafikë etj.) plotësojnë dhe mbështesin përmbajtjen e tekstit shkollor.					
3.2.	Ilustrimet kanë cilësi të lartë estetike, dokumentare apo shpjeguese.					
3.3.	Ilustrimet janë të qarta, të larmishme dhe në përshtatje me zhvillimin moshor të nxënësve dhe me përmbajtjen mësimore.					
3.4.	Ilustrimet janë të mjaftueshme dhe të shpërndara në mënyrë të arsyeshme në mbështetje të temës mësimore.					

[6] Ilustrimet nuk duhet të riprodhojnë thjesht tekstin, por të ilustrojnë ose të ofrojnë informacion shtesë që ndihmon në kuptimin e tij. Në tekstet e matematikës, shkencave të natyrës dhe gjeografisë, diagramet, tabelat dhe grafikët duhet të qartësojnë ose të përmbledhin konceptet kryesore. Në tekstet e historisë dhe të shkencave të natyrës, fotografitë dokumentuese dhe materialet pamore duhet të funksionojnë si burime autentike që thellojnë kuptimin dhe mbështesin interpretimin e saktë të përmbajtjes.

Vlera e standardit 3 = $\{[3.1 + - + 3.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

B. ÇËSHTJE SHKENCORE DHE DIDAKTIKE (STANDARDET 4-8)

Standardi 4: Cilësia në lidhje me përmbajtjen e lëndës, rëndësinë dhe aktualitetin

Qëllimet: *Përmbajtja shkencore, shtjellimi didaktik i përmbajtjeve mësimore (përfshirë, kombinimet shkrime - ilustrime) dhe situatat/përvojat e paraqitura në tekstin shkollor të tregojnë nivel të lartë dhe bashkëkohor, si dhe të përshtaten me synimet e temave mësimore të trajtuara. Duke plotësuar këtë standard, teksti shkollor t'i shërbejë ndërtimit dhe zhvillimit sistematik nga nxënësit të njohurive të reja, të kompetencave kyç dhe atyre lëndore.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
4.1.	Përmbajtja e tekstit shkollor ka cilësi të lartë në aspektin formues dhe edukativ. Ajo përshtatet me nevojat aktuale të shoqërisë dhe merr parasysh kërkesat e pritshme të së ardhmes, në mënyrë që nxënësit të përgatiten për sfidat e ndryshme me të cilat do të përballen.					
4.2.	Informacionet, situatat dhe temat mësimore në tekst janë shkencërisht të sakta dhe në përputhje me lëndën përkatëse, duke siguruar kështu një bazë të qëndrueshme për të nxënësit.					
4.3.	Teksti shkollor përmban elemente metodologjike bashkëkohore, si dhe ushtrime të përditësuara që pasqyrojnë zhvillimet më të fundit në shkencën përkatëse dhe në didaktikën e lëndës, duke garantuar kështu përmbajtje të përditësuara dhe të dobishme.					
4.4.	Teksti shkollor ndihmon në ndërtimin sistematik të njohurive të reja dhe në zhvillimin e kompetencave të nxënësve në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme.					

Vlera e standardit 4 = $\{[4.1 + - + 4.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 5: Përshtatja me moshën dhe me nevojat e nxënësve

Qëllimet: *Përmbajtjet e tekstit shkollor, pamja, niveli i vështirësisë, faqësia dhe elemente të tjera të ngjashme me këto, të përshtaten me moshën dhe me nevojat e veçanta të nxënësve. Teksti shkollor të jetë i kuptueshëm, i vlefshëm nga ana mësimore - edukative dhe tërheqës për grup-moshën në fjalë (për aspektet gjuhësore, shihni standardin përkatës).*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
5.1.	Përmbajtja mësimore dhe situatat e të nxënësit në tekstin shkollor përputhen me mundësitë njohëse dhe përvetësuese të grup-moshës					

	përkatëse.					
5.2.	Kombinimi i informacionit dhe i ilustrimeve në tekst është i përshtatshëm për përvojat dhe kërkesat e jetës së përditshme të nxënësve të grup-moshës përkatëse, duke e bërë tekstin të kuptueshëm dhe tërheqës për ta.					
5.3.	Elementet pamore të tekstit shkollor (fotografitë, grafikët etj.) përputhen me karakteristika e grup- moshës në fjalë dhe janë të kapshme dhe tërheqëse për nxënësit.					
5.4.	Teksti shkollor synon të përfshijë nxënësit me nevoja të veçanta duke ofruar materiale dhe sugjerime që ndihmojnë mësuesit të realizojnë mësimin gjithëpërfshirës dhe të personalizuar.					

Vlera e standardit 5 = $[(5.1 + \dots + 5.4) : 4] = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 6: Konceptimi dhe shtjellimet didaktike

Qëllimet: Teksti shkollor të ketë konceptim didaktik bashkëkohor që konkretizon kërkesat e qasjes që bazohet në kompetenca. Përgatitja, hartimi dhe shtjellimi i temave mësimore, i situatave të të nxënësve (ushtrime, detyra etj.), dhe i udhëzimeve të mbështetjen në zhvillimet didaktike aktuale, si: të nxënësve në mënyrë të pavarur, bashkëpunimi në grup, të nxënësve ndërveprues, gjithëpërfshirës dhe reflektues etj. Teksti shkollor të ofrojë situata, materiale dhe sugjerime të përshtatshme për nivele intelektuale të ndryshme dhe stile të ndryshme të nxënësve (kognitive/ vizuale/ vepruese etj.), që i shërbejnë arritjes së rezultateve të të nxënësve. Teksti të ofrojë mundësi për zgjedhje dhe përshtatje nga mësuesi, që t'i përgjigjet më mirë realiteteve lokale dhe nevojave të ndryshme të nxënësve.

Shënim. Struktura e kuptueshme e tekstit shkollor dhe orientimet e qarta për qëllimet dhe për rezultatet e të nxënësve ndihmojnë dhe prindërit të kuptojnë më mirë çfarë ndodh dhe çfarë kërkohet në procesin e të nxënësve, që dhe ata të jenë në gjendje t'i ndihmojnë më lehtë fëmijët e tyre.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
6.1.	Teksti shkollor është ndërtuar sipas një konceptimi didaktik të qartë dhe koherent, i cili respektohet në të gjitha aspektet e përmbajtjes dhe të organizimit të materialeve mësimore.					
6.2.	Në tekstin shkollor, temat dhe situatat e të nxënësve (shkrimet, detyrat, ushtrimet etj.), janë renditur nga e thjeshta te më e ndërlikuar.					
6.3.	Përmbajtja e tekstit është ndarë në njësi dhe në hapa pune të përshtatshëm, të qartë e të kuptueshëm për nxënësit, përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta.					
6.4.	Teksti shkollor ofron situata të nxënësve, detyra, ushtrime dhe sugjerime të qarta që ndihmojnë nxënësit të orientohen me lehtësi,					

	të vendosin synime dhe të vlerësojnë suksesin e arritjeve.					
6.5.	Teksti shkollor, përmes ilustrimeve, grafikëve, shpjegimeve të fjalëve, formulimeve, termave e koncepteve të reja, konkretizon të nxënit e qartë dhe të kuptueshëm.					
6.6.	Përmes materialeve dhe udhëzimeve të përshtatshme, teksti shkollor nxit, ku është e mundur, të nxënit në mënyrë të pavarur.					
6.7.	Teksti shkollor ofron mënyra, strategji dhe teknika për zhvillimin e aftësive metakognitive që lidhen me procesin e të nxënit.					
6.8.	Teksti shkollor ofron tema, shkrime, ushtrime etj., që janë të përshtatshme për të punuar në forma të ndryshme bashkëpunuese, komunikuese dhe ndërvepruese (p.sh.: mësim me të gjithë klasën, punë në çift, punë në grup, punë individuale, punë të pavarur).					
6.9.	Teksti shkollor përmban materiale, sugjerime, detyra etj., të cilat lejojnë shtjellime hyrëse të ndryshme në temë, sipas niveleve të ndryshme të nxënësve.					
6.10.	Teksti shkollor kontribuon në zhvillimin socio-emocional të nxënësve, nxit njohjen, shprehjen dhe menaxhimin e emocioneve, si dhe aftësitë për bashkëpunim, empati dhe respekt ndaj diversitetit, përmes përmbajtjes, pyetjeve reflektuese dhe situatave praktike.					
6.11.	Teksti shkollor përfshin burime digjitale, të cilat e mbështesin procesin mësimor dhe nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve gjatë të nxënit.					
6.12.	Përmbajtja dhe aktivitetet e përfshira në tekst ofrojnë mundësi për zgjedhje dhe përshtatje nga mësuesi, që t'i përgjigjen më mirë realiteteve lokale dhe nevojave të ndryshme të nxënësve, duke mbështetur një proces mësimor që është i pasur dhe gjithëpërfshirës.					

Vlera e standardit 6 = $[(6.1 + \dots + 6.12) : 12] = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 7: Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat

Qëllimet: *Pyetjet dhe detyrat e paraqitura në tekstet shkollore, përveç njohurive, të nxitin edhe të nxënit e aftësive, të qëndrimeve dhe të vlerave. Pyetjet të jenë të formuluar thjesht, qartë, shkurt dhe saktë; të jenë të hapura, të nxitin krijimtarinë, që nxënësit të jenë aktivë në procesin e të nxënit dhe të mund të arrijnë në përfundime të pavarura.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
7.1.	Pyetjet janë hartuar për nivele të ndryshme njohëse dhe bazohen në situatat që paraqiten në tekstin shkollor.					
7.2.	Pyetjet, në aspektin metodologjik, janë të hartuara që t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë krijimtarinë e tyre.					

7.3.	Formulimi i pyetjeve dhe i detyrave ndihmon nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, si dhe aftësinë për zgjidhjen problemore.					
7.4.	Paraqitja e detyrave në tekstin shkollor nxit nxënësit të hulumtojnë dhe të gjejnë burime të ndryshme të informacionit.					
7.5.	Detyrat e përzgjedhura në tekstin shkollor i japin përparësi punës në grup të nxënësve dhe zhvillojnë aftësitë sociale dhe emocionale.					
7.6.	Pyetjet dhe detyrat në tekstin shkollor janë në përputhje me përmbajtjen e tekstit, të kuptueshme nga nxënësit dhe të përshtatshme për moshën e tyre.					
7.7.	Teksti shkollor ofron detyra të diferencuara për nxënës me nevoja të veçanta.					

Vlera e standardit 7 = {[7.1 + - + 7.7]: 7} = ____

Standardi 8: Aspektet gjuhësore

Qëllimet: *Gjuha e tekstit shkollor duhet të jetë në përputhje me normat e gjuhës standarde. Ajo t'u shërbejë nxënësve për formimin dhe zbatimin e kompetencave kyç, veçanërisht të kompetencës së komunikimit në gjuhën amtare. Nëpërmjet gjuhës së tekstit shkollor, nxënësi të përkushtohet dhe të kontribuojë në një bashkëbisedim të frytshëm, të respektojë rregullat e komunikimit dhe të shprehë tolerancë e empati gjatë komunikimit. Nga ana leksikore dhe sintaksore, gjatësia e shkrimeve mësimore duhet t'u përshtatet moshës dhe aftësive gjuhësore të nxënësve për të cilët teksti është përgatitur. Formulimet, sidomos ato të udhëzimeve, pyetjeve dhe detyrave, duhet të jenë të kuptueshme dhe të thjeshta, për të nxitur të nxënësit e pavarur të nxënësve. Për të njëjtën temë, teksti shkollor duhet të ofrojë shkrime dhe materiale me nivele të ndryshme gjuhësore, duke përfshirë edhe materiale për nxënësit me nevoja të veçanta, në mënyrë që të mbështeten gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja aktive e tyre.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
8.1.	Leksiku dhe fjalori i përdorur në tekst është i përshtatshëm për moshën e nxënësve.					
8.2.	Ndërtimi sintaksor dhe struktura gjuhësore e tekstit shkollor përputhen me aftësitë gjuhësore të nxënësve dhe i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësitë e lexim-shkrimit.					
8.3.	Gjatësia e teksteve dhe e shkrimeve është në përshtatje me moshën dhe me aftësitë e leximit të nxënësve.					
8.4.	Formulimet, sidomos të udhëzimeve, detyrave dhe pyetjeve janë të qarta dhe të thjeshta, në mënyrë që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.					
8.5.	Teksti shkollor ofron materiale me nivele të ndryshme gjuhësore, që u përshtaten aftësive të ndryshme të nxënësve.					
8.6.	Gjuha e tekstit shkollor, në aspektet morfologjike, sintaksore dhe					

	drejtshkrimore, përputhet plotësisht me normat e standardit të gjuhës.					
8.7.	Teksti shkollor përfshin edhe materiale për nxënësit me nevoja të veçanta, me fjalor të qartë, struktura të thjeshta dhe shpjegime ndihmëse që lehtësojnë kuptimin dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin mësimor.					

Vlera e standardit 8 = $\{[8.1 + - + 8.7] : 7\} = \underline{\hspace{2cm}}$

C. ÇËSHTJE PEDAGOGJIKE (STANDARDET 9-12)

Standardi 9: Lidhja me realitetet politike, historike dhe shoqërore

Qëllimet: *Teksti shkollor të lidhet me realitetet shoqërore, historike dhe kulturore shqiptare, t'i shmanget çdo njëanshmërie dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ndihmojë dhe të nxitë pranimin, tolerancën, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe komunikimin mes kulturave. Teksti duhet të pasqyrojë gjithashtu larminë etnike dhe gjuhësore të vendit, të përfaqësojë me dinjitet dhe pa paragjykim pakicat kombëtare dhe komunitetet e ndryshme kulturore, duke kontribuar në respektimin dhe ruajtjen e identitetit të tyre dhe në gjithëpërfshirjen sociale.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
9.1.	Teksti shkollor, në aspektet politike, etnike dhe fetare, nxit tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin.					
9.2.	Teksti shkollor krijon lidhje të qarta dhe të përditësuara me jetën dhe realitetin në Shqipëri (shoqëror, historik, gjeografik, shkencor dhe kulturor).					
9.3.	Teksti shkollor shmang njëanshmërinë ndaj grupeve ose individëve dhe pasqyron realitetin demokratik, duke i shërbyer mirëkuptimit dhe bashkëjetesës së qëndrueshme.					
9.4.	Në tekstin shkollor, aspektet historike, aty ku ka, trajtohen në mënyrë objektive dhe pa ngarkesë emocionale.					
9.5.	Teksti shkollor pasqyron praninë dhe diversitetin e pakicave kombëtare në Shqipëri, duke theksuar kulturën dhe kontributin e tyre në jetën shoqërore dhe historike të vendit. ⁷					

Vlera e standardit 9 = $\{[9.1 + - + 9.5] : 5\} = \underline{\hspace{2cm}}$

⁷ Të vlerësohen këta tregues, nëse ka aspekte historike. Nëse nuk ka, këta tregues të mos vlerësohen dhe vlera e standardit të dalë nga treguesit e tjerë (të llogaritet vlera e standardit me numrin e treguesve të plotësuar).

Standardi 10: Çështjet edukative, pavarësia, edukimi për demokraci dhe paqe

Qëllimet: Teksti shkollor të nxisë zhvillimin e nxënësve si qytetarë të pjekur, të pavarur, që marrin vendime; të përfshijë vlera demokratike dhe paqësore (tolerancë, bashkëpunim, përgjegjësi, kurajë qytetare, integritet, heqje dorë nga dhuna, mbrojtje e pakicave). Kjo mund të realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në lëndët: Gjuhë shqipe, Qytetari, Histori etj., si dhe në mënyrë të tërthortë me pyetje, detyra, situata që nxisin dialog dhe ndërveprim mes nxënësve në të gjitha lëndët.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
10.1.	Teksti krijon mundësi që nxënësi të zhvillojë pjekuri dhe pavarësi përmes shkrimeve, materialeve, pyetjeve, detyrave etj., të cilat e nxisin dhe e mbështesin të mendojë në mënyrë të pavarur dhe kritike.					
10.2.	Teksti shkollor, nëpërmjet pyetjeve dhe detyrave të përshtatshme, kontribuon në edukimin për demokraci dhe paqe, duke nxitur dialogun, respektin, tolerancën, bashkëpunimin dhe menaxhimin e konflikteve.					
10.3.	Teksti shkollor mbështet zhvillimin e njohurive dhe të kompetencave qytetare dhe sociale të nxënësit, duke e përgatitur që të bëhet qytetar i përgjegjshëm dhe aktiv në shoqëri.					

Vlera e standardit 10 = $\{[10.1 + - + 10.3] : 3\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 11: Pasqyrimi i barazisë gjinore në tekstin shkollor

Qëllimet: Teksti shkollor të edukojë barazinë gjinore, të shmangë dallimet lidhur me gjininë dhe stereotipat gjinorë në lidhje me ndarjen e roleve. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndihmesa të jepet nga tekstet shkollore të disa fushave/ lëndëve (Gjuhë shqipe, Letërsi Shkenca shoqërore), nëpërmjet zgjedhjes së përshtatshme të situatave (shkrime, pyetje dhe detyra). Në mënyrë të tërthortë, të gjitha tekstet shkollore duhet të plotësojnë këtë standard, duke u kujdesur që në shkrime, në ilustrime, në detyra etj., femrat dhe meshkujt të jenë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe jo sipas stereotipave tradicionale.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
11.1	Në shkrimet, ilustrimet, detyrat, pyetjet etj., meshkujt dhe femrat janë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe po aq shpesh, kur e lejon natyra e temës.					
11.2.	Në shkrimet e ilustrimeve, detyrave, pyetjeve etj., teksti shkollor u referohet në mënyrë të barabartë përvojave dhe interesave të femrave dhe të meshkujve.					
11.3.	Teksti shkollor u shmanget stereotipave gjinorë, në lidhje me					

	ndarjen e roleve dhe të pamjeve të njëanshme, duke treguar dhe paraqitur femra dhe meshkuj në veprimtari dhe kontekste të ndryshme.					
11.4.	Të dyja gjinitë portretizohen, pasqyrohen dhe kanë role në mënyrë të barabartë si në jetën private (në familje), ashtu dhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore (në sferën publike, në kontekstin historik etj.).					
11.5.	Përdorimi i gjuhës është i drejtë dhe i barabartë për të dyja gjinitë, sidomos kur përdoren format femërore dhe mashkullore në emërtimin e personave.					
11.6.	Teksti shkollor ka shtrirje sasiore dhe kombinim cilësor të fotografive dhe të veprave të artit, në lidhje me barazinë gjinore dhe në përputhje të plotë me temat dhe kapitujt që trajton.					

Vlera e standardit 11 = $\{[11.1 + - + 11.6] : 6\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 12: Integrimi ndërlëndor dhe i temave ndërkurrikulare

Qëllimet: *Teksti shkollor të kontribuojë në zhvillimin personal dhe shoqëror të nxënësve si qytetarë të pavarur, të përgjegjshëm dhe të aftë të marrin vendime të drejta. Ai duhet të integrojë në mënyrë të natyrshme temat ndërkurrikulare të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, të cilat janë: Identiteti kombëtar; Qytetaria aktive dhe sipërmarrja; Shëndeti mendor e fizik dhe siguria; Zhvillimi i qëndrueshëm; Teknologjia, shoqëria dhe media.*
Gjithashtu, teksti duhet të krijojë lidhje ndërlëndore, duke shfrytëzuar njohuri, aftësi dhe koncepte nga lëndë të ndryshme për të ndihmuar nxënësin të kuptojë në mënyrë të integruar përmbajtjet mësimore dhe të zhvillojë kompetenca që shkojnë përtej kufijve të një lënde të vetme.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
12.1.	Teksti shkollor promovon atdhedashurinë, trashëgiminë kulturore, historinë dhe vlerat kombëtare, si dhe respektin për kulturat e tjera.					
12.2.	Teksti shkollor nxit përgjegjësi qytetare, pjesëmarrje shoqërore, iniciativë dhe zhvillimin e mendësisë sipërmarrëse.					
12.3.	Teksti shkollor mbështet kujdesin për shëndetin, mirëqenien emocionale dhe sigurinë personale e komunitare.					
12.4.	Teksti shkollor promovon ruajtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe ndërgjegjësimin për ndikimin ekologjik.					
12.5.	Teksti shkollor trajton çështje të lidhura me fatkeqësitë natyrore dhe situatat e emergjencës, duke ofruar njohuri dhe udhëzime për reagimin e sigurt, parandalimin dhe ndërgjegjësimin mbi menaxhimin e rreziqeve në mjedisin shoqëror e natyror.					

12.6.	Teksti shkollor promovon përdorimin etik dhe kritik të teknologjisë dhe mediave, si dhe ndërgjegjësimin për ndikimin e tyre në shoqëri.					
12.7.	Teksti shkollor orientohet drejt përdorimit të ndërgjegjshëm të IA-së, zhvillimit të aftësive për të menduar në mënyrë kritike mbi informacionin e gjeneruar nga IA dhe ndërgjegjësimin për aspektet etike dhe shoqërore të saj.					
12.8.	Teksti shkollor krijon lidhje të qarta mes lëndës që trajton dhe fushave/lëndëve të tjera të të nxënës, duke integruar tema dhe koncepte nga lëndë të ndryshme për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë marrëdhënien dhe bashkëveprimin mes këtyre lëndëve.					
12.9.	Në tekst, qasja ndërlëndore dhe temat ndërkurrikulare nxitin mendimin kritik dhe krijues, duke ofruar mundësi për eksplorim dhe zgjidhje të problemeve që kërkojnë njohuri dhe aftësi nga më shumë se një fushë të nxënë ose lëndë mësimore.					

Vlera e standardit 12 = {[12.1 + - + 12.9] : 9} = ____

D. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME PRAKTIKËN SHKOLLORE (STANDARDET 13-14)

Standardi 13: Teksti i mësuesit dhe përdorimi i tij

Qëllimet: Teksti i mësuesit duhet të shpjegojë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme qëllimet e tekstit shkollor, konceptimin didaktik, strukturën dhe pikat kyç të tij, si dhe mënyrat e planifikimit dhe të zhvillimit të procesit mësimor duke përdorur tekstin. Ai duhet të ofrojë udhëzime dhe orientime konkrete, të shkurtra dhe të zbatueshme për trajtimin e situatave mësimore, shkrimeve, materialeve, ushtrimeve dhe veprimtarive të përfshira në tekstin e nxënësit. Teksti i mësuesit duhet të ndihmojë mësuesin të menaxhojë punën dhe të shërbejë si mjet orientues për organizimin e procesit mësimor në përputhje me qasjen e bazuar në kompetenca.

Shënim: Për vlerësimin e teksteve të matematikës, të shkencave të natyrës dhe të gjuhëve të huaja që janë përshtatur nga/ose janë botime ndërkombëtare, si tekst i mësuesit pranohet dhe përdoret teksti origjinal i mësuesit i publikuar nga shtëpia botuese përkatëse, si pjesë e paketës zyrtare të produktit. Përveç lëndëve të gjuhëve të huaja, teksti i mësuesit për të gjitha lëndët e tjera të mësimërme duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
13.1.	Teksti i mësuesit shpjegon qartë qëllimin dhe funksionin e tij si mjet që ndihmon mësuesin të përdorë në mënyrë efektive tekstin shkollor.					
13.2.	Teksti i mësuesit informon në mënyrë të qartë dhe të kapshme për qëllimet, konceptimin didaktik, ndërtimin, pikat kyç të tekstit dhe mënyrën e përdorimit të tij, në kontekstin e qasjes së bazuar në kompetenca.					

13.3.	Teksti i mësuesit jep orientime konkrete dhe të zbatueshme për trajtimin didaktik të temave, nën-temave, faqeve, ushtrimeve dhe materialeve të tekstit.					
13.4.	Teksti i mësuesit përmban orientime për planifikimin e procesit mësimor.					
13.5.	Struktura dhe paraqitja e tekstit të mësuesit e bëjnë atë të lehtë për t'u përdorur dhe e ndihmojnë mësuesin të integrojë me efikasitet tekstin shkollor në procesin mësimor.					
13.6.	Teksti i mësuesit ofron udhëzime dhe shembuj për vlerësimin e nxënësve (për të nxënë dhe i të nxënit), duke ndihmuar mësuesin të vlerësojë përparimin dhe arritjet sipas kompetencave dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.					
13.7.	Teksti i mësuesit përfshin orientime për përdorimin e burimeve digjitale dhe platformave online (materiale multimediale, mjete ndërvepruese, aplikacione, IA etj.) për të mbështetur mësimdhënien bashkëkohore dhe të gjithëpërfshirëse.					
13.8.	Teksti i mësuesit ofron metodologji dhe strategji për të nxitur gjithëpërfshirjen dhe motivimin e të gjithë nxënësve, duke përfshirë udhëzime të posaçme për përshtatjen e mësimi sipas nevojave të nxënësve të talentuar, me aftësi të ndryshme dhe me nevoja të veçanta.					
13.9.	Teksti i mësuesit përmban orientime për përgatitjen e nxënësve për vlerësimet kombëtare (pyetje dhe teste model), duke ofruar këshilla për përdorimin e kompetencave dhe njohurive të fituara gjatë mësimi në përputhje me kërkesat e këtyre vlerësimeve ⁸ .					

Vlera e standardit 13 = $\{[13.1 + \dots + 13.9] : 9\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 14: Materialet që shoqërojnë tekstin shkollor⁹

Qëllimet: Teksti shkollor të shoqërohet me materiale pune (p.sh., fletore pune, antologji, modele projektesh etj.), që ndihmojnë dhe nxisin përvetësimin, zbatimin dhe transferimin e njohurive të reja dhe kompetencave.

Materialet mund të jenë:

- të integruara në tekstin shkollor (p.sh., detyra, ushtrime, pyetje reflektuese, aktivitete ndërvepruese);
- të veçanta si botime ndihmëse ose fletore pune që mësuesi mund t'i përshtatë sipas nevojave të klasës;
- burime multimediale dhe digjitale.

Materialet duhet të jenë të larmishme, motivuese dhe gjithëpërfshirëse, të përshtaten me nivele të ndryshme të aftësive dhe stileve të të nxënit, duke mbështetur edhe

⁸ Ky tregues të vlerësohet për lëndët që janë pjesë e provimeve/vlerësimeve kombëtare.

⁹ Standardi 14: Të vlerësohet vetëm për ato tekste shkollore, të cilat janë të shoqëruara me materiale ndihmëse.

nxënësit me nevoja të veçanta dhe duke respektuar parimet e Dizajnit Universal për të Nxënësit (UDL).

Ato duhet të ndihmojnë mësuesin dhe nxënësit për zbatimin e qasjes së bazuar në kompetenca dhe të mundësojnë mësim aktiv, bashkëpunues dhe krijues.

Shënim: Ky standard të vlerësohet vetëm për ato tekste shkollore, të cilat janë të shoqëruara me materiale ndihmëse.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
14.1	Materialet e punës lidhen tërësisht me përmbajtjen e tekstit shkollor, janë të përfshira sipas rrjedhës logjike dhe plotësojnë në mënyrë të ndërsjellë përmbajtjen e tij.					
14.2	Teksti shkollor përmban, si pjesë të tij ose si pjesë të veçanta, materiale pune që shërbejnë për përpunimin, përvetësimin, zbatimin dhe transferimin e njohurive dhe të kompetencave të fituara.					
14.3	Materialet e punës janë të larmishme, të shumëllojshme dhe përshtaten me nivele të ndryshme të aftësive, stileve të të nxënësit dhe nevojave të veçanta të nxënësve, duke mbështetur mësimin gjithëpërfshirës.					
14.4	Materialet përfshijnë burime dhe platforma digjitale (p.sh., video, audio, aplikacione, IA, mjete ndërvepruese) që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore, vlerësimin dhe rrisin motivimin e nxënësve.					

Vlera e standardit 14 = $\{[14.1 + - + 14.4] : 4\} =$ _____

PJESA III

STANDARDET LËNDORE

15. STANDARDET LËNDORE

15.1 GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

15.1.1 Abetarja

Qëllimet: Teksti i abetares të zhvillojë aftësitë bazë të leximit dhe të shkrimit fillestar; të ketë progresion të arsyetuar të shkronjave dhe të lidhjeve tingull-shkronjë; të përdorë fjalor të thjeshtë e të përshtatshëm dhe të përfshijë tekste të qarta e në përshtatje me moshën e nxënësve.

Teksti të mbështesë mësimdhënien e diferencuar dhe gjithëpërfshirjen, të shmangë vështirësitë e leximit, të nxisë pavarësinë dhe mendimin kritik të nxënësve, të përdorë elemente pamore dhe tipografi të përshtatshme për nxënësit dhe të ofrojë detyra që i motivojnë të lexojnë dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.1.1.1	Abetarja siguron që nxënësit, që në fillim të vitit shkollor, të kuptojnë mundësitë e shkrimit dhe të leximit, të mësojnë teknikat bazë të tyre dhe të shmanget rreziku i mësimi mekanik të shkronjave.					
15.1.1.2	Rendi i mësimi të shkronjave dhe i lidhjeve tingull-shkronjë është i arsyetuar (p.sh., sipas shpeshtësisë së përdorimit të shkronjave dhe vështirësisë fonetike).					
15.1.1.3	Leksiku i tekstit shkollor përfshin fjalë të thjeshta dhe që janë pjesë e fjalorit të përditshëm ose të zakonshëm të nxënësve.					
15.1.1.4	Abetarja respekton veçoritë gjuhësore dhe ndihmon gradualisht nxënësit të njihen dhe të përdorin gjuhën shqipe standarde.					
15.1.1.5	Abetarja merr parasysh vështirësitë e lexim-shkrimit, si p.sh., probleme/ngatërrime të fonemave të ngjashme, si ç, q, gj, xh në gjuhën shqipe dhe të shkronjave të ngjashme si b – d, probleme të lidhjes së shkronjave gjatë leximit etj.					
15.1.1.6	Për të lehtësuar dhe për të nxitur procesin e leximit, shkrimet, të paktën në dy të tretat e para të abetares, jepen jo në rreshta të zakonshëm, por ndahen që secili rresht të përmbajë vetëm një njësi sintaksore apo kuptimore.					
15.1.1.7	Abetarja përdor lloje shkronjash që lexohen lehtë, që janë të përshtatshme për moshën dhe, veçanërisht në fillim, shkronja mjaft të mëdha.					
15.1.1.8	Largësia mes rreshtave është mjaft e madhe, që faqet të jenë të qarta e të kapshme dhe të lehtësohet orientimi i nxënësve në					

	tekst.					
15.1.1.9	Për të ndihmuar zhvillimin gjuhësor të nxënësve, sidomos për fazën fillestare, abetarja ofron shumë fotografi, piktura etj., dhe sugjerime përkatëse me karakter motivues për biseda dhe komunikim gojor.					
15.1.1.10	Abetarja nxit punën e pavarur të nxënësve, p.sh., përmes një numri të caktuar të piktogrameve në lidhje me udhëzime dhe detyra (p.sh., shenja ✎ për foljen <i>shkruaj</i>) dhe me paraqitje të kuptueshme të ushtrimeve.					
15.1.1.11	Abetarja përmban situata të nxëni (detyra/ushtrime shtesë për nxënës/e të niveleve të ndryshme).					
15.1.1.12	Abetarja merr parasysh që njohuritë paraprake të nxënësve në proceset e shkrimit e të leximit, në fillim të klasës së parë, ndryshojnë shumë. Për këtë arsye, abetarja ofron ndihmë dhe materiale për dallimet mes nxënësve dhe individualizimin e të nxënit (p.sh., një tabelë me të gjitha shkronjat si mbështetje e të nxënit në mënyrë të pavarur).					
15.1.1.13	Aftësitë fillestare të leximit dhe të shkrimit zhvillohen në mënyrë efektive përmes situatave të larmishme dhe motivuese, të cilat mundësojnë përsëritjen sistematike të shkronjave dhe të korrelacioneve tingull-shkronjë të mësuara.					
15.1.1.14	Abetarja ndihmon aftësitë e dekodimit dhe të kuptuarit. Këtij qëllimi (d.m.th., nxënësit edhe të mendojnë për atë që kanë lexuar), i shërbejnë shmangia e teksteve të pakuptueshme, përdorimi i fjalive korrekte nga ana sintaksore (të plotësuara me simbole apo piktura për fjalë që ende s'mund të lexohen), si dhe udhëzimet dhe pyetjet përkatëse.					
15.1.1.15	Abetarja përmban orientime dhe ushtrime të mjaftueshme për zhvillimin e aftësive motorike fine që lidhen me procesin e shkrimit.					

Vlera e standardit 15.1.1 = {[15.1.1.1 + - + 15.1.1.15 : 15]} = ____

15. 1. 2 Gjuha shqipe për shkollën 9-vjeçare; Gjuha amtare për pakicat kombëtare; Gjuha shqipe dhe Letërsia për arsimin e mesëm të lartë.¹⁰

Qëllimet: Teksti të zhvillojë të gjitha kompetencat gjuhësore dhe letrare të nxënësve. Theksi kryesor të vihet tek aftësia e tyre për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të gjykuar çështje gjuhësore dhe letrare.

¹⁰ Nëse ka tregues që nuk janë pjesë e lëndës, vlera e standardit të dalë nga treguesit e tjerë (të llogaritet vlera e standardit me numrin e treguesve të plotësuar).

Për këtë qëllim, përmbajtja e tekstit të jetë e ndërtuar qartë, e sistemuar mirë dhe e paraqitur në mënyrë që nxënësi të kuptojë, të praktikojë dhe të zbatojë njohuritë e reja në situata të ndryshme mësimore.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.1.2.1.	Përmbajtja e tekstit shkollor, struktura dhe koncepti didaktik i tij (përfshirë temat, detyrat, pyetjet, ushtrimet) janë në funksion të zhvillimit të kompetencës së komunikimit në gjuhën amtare.					
15.1.2.2.	Materialet, udhëzimet dhe detyrat i referohen botës reale dhe mjedisit gjuhësor të nxënësve, duke përfshirë situata autentike nga jeta e tyre dhe fragmente letrare që lidhen me përvoja jetësore, vlera dhe identitetin kombëtar.					
15.1.2.3.	Në tekstin shkollor respektohen dhe zhvillohen në mënyrë të baraspeshuar aftësitë e komunikimit: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, si dhe njohuritë dhe aftësitë rreth sistemit gjuhësor.					
15.1.2.4.	Teksti shkollor respekton pasurinë leksikore, i përmbahet gjuhës standarde dhe krijon mundësi që nxënësit ta njohin dhe ta zotërojnë atë.					
15.1.2.5.	Teksti shkollor ofron mundësi që nxënësit të kuptojnë përmes të dëgjuarit, të shprehjen lirshëm dhe të kuptohen.					
15.1.2.6.	Teksti shkollor ofron tema përmes të cilave nxënësit pasurojnë dhe thellojnë në mënyrë sistematike fjalorin e tyre me fjalë dhe me shprehje të reja.					
15.1.2.7.	Teksti shkollor kultivon të lexuarit shprehës (ekspresiv), përmes elementeve gjuhësore si intonacioni, ritmi, melodia, shenjat e pikësimit.					
15.1.2.8.	Teksti shkollor ofron situata të nxëni ku nxënësit zhvillojnë aftësitë e të shkruarit në mënyrë krijuese, kritike dhe duke përdorur teknologjinë.					
15.1.2.9.	Teksti shkollor përmban situata mësimore për të nxënë gramatikën në kontekst dhe që ndihmojnë nxënësit të përdorin dhe të vlerësojnë gjuhën standarde.					
15.1.2.10.	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punën me nxënës me nevoja të veçanta dhe për nxënie individuale, pasi ofron situata dhe ushtrime me nivele të ndryshme vështirësie.					
15.1.2.11.	Teksti shkollor ofron mënyra dhe teknika për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e rezultateve të të nxënit.					
15.1.2.12.	Situatat e të nxënit (detyrat, orientimet për punë të mëtejshme dhe ushtrimet) nxisin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve.					
15.1.2.13.	Teksti shkollor ofron mundësi dhe situata të nxëni që nxënësit					

	të respektojnë larminë gjuhësore, si dhe të krahasojnë gjuhën amtare me gjuhët e tjera që mësojnë në shkollë ose jashtë saj.					
15.1.2.14.	Teksti shkollor respekton parimin e integritetit mes gjuhës së folur, të lexuarit, të shkruarit dhe njohurive nga sistemi gramatikor i gjuhës amtare.					
15.1.2.15.	Teksti shkollor siguron integritetin mes gjuhës amtare, letërsisë dhe fushave të tjera të të nxënësve/ lëndëve si: historia, gjeografia, artet etj.					
15.1.2.16.	Temat, detyrat dhe ushtrimet në tekstin shkollor janë të renditura në shkallë të ndryshme vështirësie, duke filluar nga të thjeshtat, tek ato më të vështira.					
15.1.2.17.	Teksti shkollor përfshin tekste ose fragmente nga letërsia përfaqësuese shqipe dhe botërore, të përzgjedhura për të zhvilluar kompetencat gjuhësore dhe letrare.					
15.1.2.18.	Teksti shkollor ofron detyra, ushtrime etj., të mjaftueshme që garantojnë përsëritjen, thellimin sistematik, vlerësimin dhe vetëvlerësimin e njohurive të reja dhe të kompetencave.					
15.1.2.19.	Teksti shkollor përmban detyra dhe udhëzime lidhur me përdorimin e burimeve digjitale për të nxënësit e gjuhës dhe letërsisë.					

Vlera e standardit 15.1.2 = {[15.1.2.1 + - + 15.1.2.19] : 19} = ____

15.1.3. Gjuhët e huaja

Qëllimet: Në lëndën “Gjuhë e huaj” të përdoren tekstet origjinale në linjë për gjuhët e huaja të ofruara nga kompani të huaja.

Për tekste origjinale të huaja në trajtë linje të gjuhëve: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht etj., të përdoren standardet evropiane duke u mbështetur në Kuadrin Evropian të Referencave për Gjuhët, Volumi Shoqërues 2020.

Teksti shkollor për gjuhët e huaja të ketë përmbajtje të integruara që zhvillojnë kompetencat gjuhësore të nxënësve për komunikim dhe ndërveprim përmes zhvillimit të veprimtarive që ndihmojnë në marrjen e informacionit, prodhimin e informacionit, ndërveprimin dhe ndërmjetësimin gjuhësor. Për sa i përket didaktikës, zhvillimi i nxënësve duhet ndjekur në mënyrë sistematike, hap pas hapi, prej të thjeshtës deri te dukuritë komplekse, me situata tërheqëse të nxënë (informacion, detyra, ushtrime etj.), që sigurojnë përsëritjen, thellimin dhe zbatimin e kompetencave të fituara.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.1.3.1	Përmbajtja e tekstit shkollor është e afërt me jetën, mbështetet në realitet dhe u intereson nxënësve.					
15.1.3.2	Përmbajtja e tekstit shkollor, struktura dhe koncepti didaktik i tij (përfshirë temat, detyrat, pyetjet, ushtrimet) janë në funksion të zhvillimit të kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit në					

	gjuhë të huaj.					
15.1.3.3	Në tekstin shkollor respektohen dhe zhvillohen në mënyrë të baraspeshuar aftësitë e komunikimit: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit si dhe të kuptuarit e sistemit gjuhësor.					
15.1.3.4	Përmbajtjet e sistemit gjuhësor ofrohen, duke pasur parasysh moshën dhe kompetencat psiko-fizike të nxënësve.					
15.1.3.5	Teksti shkollor ofron mundësi që nxënësit të kuptojnë përmes të dëgjuarit, të shprehen lirshëm dhe të kuptohen.					
15.1.3.6	Teksti shkollor ofron tema përmes të cilave nxënësit pasurojnë dhe thellojnë në mënyrë sistematike fjalorin e tyre me fjalë dhe shprehje të reja.					
15.1.3.7	Teksti shkollor ofron shkrime përmes të cilave nxënësit, duke lexuar, marrin dhe kuptojnë informacione të ndryshme për gjuhën, kulturën dhe vendet përkatëse.					
15.1.3.8	Teksti shkollor kultivon të lexuarit shprehës (ekspresiv), përmes elementeve gjuhësore si intonacioni, ritmi, melodia, timbri, shenjat e pikësimit.					
15.1.3.9.	Teksti shkollor ofron situata të nxëni ku nxënësit zhvillojnë shkathtësitë e të shkruarit drejt dhe të kuptueshëm.					
15.1.3.10	Teksti shkollor ofron situata të nxëni (shkrime, tema dhe detyra) nga lëndët e tjera, në kuadër të programeve përkatëse.					
15.1.3.11	Teksti shkollor, përmes gjuhës së tij, fotografive dhe ilustrimeve, ndihmon barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, tolerancën dhe kultivon edukimin ndërkulturor.					
15.1.3.12	Teksti shkollor kontribuon në njohjen e kulturës së vendit përkatës, në raport me aspektet e ndërsjella kulturore.					
15.1.3.13	Teksti shkollor ofron situata për të nxënë në mënyrë sistematike dhe që lehtësojnë komunikimin ndërkulturor.					
15.1.3.14	Teksti shkollor ofron shkrime, tema dhe detyra interesante që nxitin dëshirën e nxënësit për të nxënë gjuhën e huaj.					
15.1.3.15	Teksti shkollor paraqet situata (shembuj, ushtrime, pyetje dhe detyra) që ndihmojnë punën e pavarur dhe aktive të nxënësve në procesin e të nxënit.					
15.1.3.16	Teksti shkollor u mundëson nxënësve bashkëpunim dhe punë në grup që të përfshihen në veprimtaritë e planifikuara për nxënien ndërvepruese.					
15.1.3.17	Teksti shkollor ofron situata (shembuj, ushtrime, pyetje) që zhvillojnë mendimin kritik, zgjidhjen problemore dhe krijimtarinë e nxënësve.					
15.1.3.18	Teksti shkollor jep shembuj për mënyrën e të nxënit, që nxënësi të përjetojë atë që nxë dhe të reflektojë përmes lojës ose roleve të ndryshme, në klasë dhe në jetën e përditshme.					
15.1.3.19	Temat, detyrat dhe ushtrimet në tekstin shkollor janë të					

	renditura në shkallë të ndryshme të vështirësisë, duke filluar nga të thjeshtat, tek ato më të vështira.					
15.1.3.20	Teksti shkollor ofron detyra, ushtrime etj., të mjaftueshme që garantojnë përsëritjen, thellimin sistematik, vlerësimin dhe vetëvlerësimin e njohurive të reja dhe të kompetencave.					

Vlera e standardit 15.1.3 = {[15.1.3.1 + - + 15.1.3.20] : 20} = ____

15.1.4. Gjuha shqipe për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë

Qëllimet: *Teksti shkollor i gjuhës shqipe për pakicat kombëtare të ketë përmbajtje të integruara që zhvillojnë kompetencat e nxënësve për komunikim dhe ndërveprim, përmes zhvillimit të aftësive gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit si dhe të kuptuarit e sistemit gjuhësor përmes përdorimit. Teksti shkollor të ketë situata me përmbajtje ndërlëndore dhe ndërkulturore, duke pasur parasysh momente, ngjarje dhe festa të veçanta. Teksti shkollor të reflektojë shembuj pozitivë, përmes të cilëve përcillet respekti për kultura dhe për popuj të ndryshëm të botës. Teksti shkollor t'i përgjigjet moshës së nxënësve, duke zbatuar metodologji bashkëkohore. Teksti të sjellë kënaqësi të nxënësit, duke i nxitur për studime të mëtejme për gjuhën shqipe.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.1.4.1	Teksti shkollor ndihmon në ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore në të gjitha aspektet: dëgjim, të folur, lexim, shkrim dhe sistem gjuhësor.					
15.1.4.2	Teksti shkollor zhvillon të menduarit për gjuhën, aspektet e komunikimit, korrelacionin e gjuhës amtare me gjuhën shqipe dhe krahasimin me të.					
15.1.4.3	Teksti shkollor shoqërohet me figura, fotografi, pamje nga jeta aktuale dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë dhe shkrime të shkurtra që zgjojnë interesimin dhe motivojnë nxënësit të merren me gjuhën shqipe në mënyrë hulumtuese, krijuese dhe argëtuese.					
15.1.4.4	Teksti shkollor mban parasysh veçoritë gjuhësore të grupeve etnike, në funksion të integritetit dhe të krahasimit të kulturave, për edukimin me frymën e tolerancës, të respektit dhe të komunikimit ndëretnik.					
15.1.4.5	Teksti shkollor është shkruar me shkrim të lexueshëm e të përshtatshëm nga ana tipografike, veçanërisht në fillim, me shkronja të mëdha.					
15.1.4.6	Teksti shkollor përfshin situata dhe ushtrime në përshtatje me moshën e nxënësit, si dhe trajton tema tërheqëse dhe të zbatueshme në komunikimin e përditshëm.					
15.1.4.7	Teksti shkollor është i përshtatshëm për mësim individual dhe					

	përmban figura të kuptueshme, vizatime, fotografi, detyra dhe ushtrime të ndryshme për nivelin përkatës. Këto janë të shoqëruara gjithmonë me fjalorin përkatës.					
15.1.4.8	Teksti shkollor përmban elemente nëpërmjet të cilave synohet që nxënësit të njihen me ligjshmëritë themelore të gjuhës standarde, të krijimtarisë letrare dhe të krijimtarisë kulturore të vendit.					
15.1.4.9	Teksti shkollor nxit nxënësit të përdorin me kënaqësi gjuhën shqipe edhe në kontekstin edukativ e ndërkulturor.					
15.1.4.10	Teksti shkollor përmban situata që përputhen me njohuritë paraprake të gjuhës amtare dhe me njohuritë e reja të gjuhës shqipe, përfshirë krahasimin e fjalëve, të dialekteve dhe të kulturave të ndryshme.					
15.1.4.11	Teksti shkollor paraqet situata që nxitin mendimin, krijimtarinë dhe kureshtjen e nxënësit për të punuar në mënyrë të pavarur.					
15.1.4.12	Teksti shkollor ofron mundësi dhe teknika përmes të cilave nxënësit mund të vetëvlerësohen për arritjet në zotërimin e gjuhës shqipe.					
15.1.4.13	Teksti shkollor integron edhe pjesë nga lëndët e tjera si histori, gjeografi, gjuhë shqipe, letërsi etj.					
15.1.4.14	Teksti shkollor përmban detyra dhe udhëzime lidhur me përdorimin e burimeve digjitale për të nxënësit e gjuhës.					

Vlera e standardit 15.1.4 = {[15.1.4.1 + - + 15.1.4.14] : 14} = _____

STANDARDI 15.2. MATEMATIKA

Qëllimet: Standardi dhe treguesit përkatës të pasqyrojnë konceptin aktual shkencor - didaktik, të njohur gjerësisht, që të nxënit në lëndën e matematikës nuk kufizohet në numërimin dhe në njehsimin, por përfshin një fushë të gjerë (kuptimi i numrave, i operacioneve dhe i procedurave matematikore, i mënyrave të ndryshme të llogaritjes, i matjeve, i përdorimeve praktike të matematikës etj.).

Teksti shkollor të lozë rolin e mjetit që mundëson ndërtimin/zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave matematikore nga nxënësit dhe të zhvillojë pavarësinë e tyre për të trajtuar situata reale. Këtij qëllimi t'i shërbejnë, ndër të tjera, situatat matematikore, udhëzimet për procedurat e të nxënit etj., si dhe përgatitja, hartimi dhe paraqitja e situatave motivuese dhe origjinale me të cilat nxënësit ndërveprojnë në mënyrë aktive, krijuese dhe reflektuese për ndërtimin e kompetencave matematikore.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.2.1	Ndërtimi dhe struktura e tekstit shkollor janë të qartë e të kapshëm, lejojnë orientim të shpejtë dhe të lehtë në të.					
15.2.2	Formatet, mënyrat dhe situatat e të nxënit që paraqesin çështje dhe detyra matematikore, janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
15.2.3	Gjuha e përdorur në udhëzimet dhe në situatat e nxënies (llogaritjet/ detyrat etj.) është e thjeshtë dhe e orientuar drejt gjuhës së përditshme (në trajtën standarde). Teksti shkollor u shmanget fjalëve të rralla dhe ndërtimeve sintaksore të vështira.					
15.2.4	Teksti shkollor ndihmon zhvillimin e kompetencave matematikore (zgjidhja problemore në matematikë, arsyetimi dhe vërtetimi matematik, të menduarit dhe komunikimi matematik, lidhja konceptuale, modelimi matematik, përdorimi i teknologjisë në matematikë dhe të menduarit kompjuterik).					
15.2.5	Konceptet matematikore, si dhe kuptimi i lidhjeve/relacioneve, i veprimeve, i analizave etj., ndërtohen dhe zhvillohen me kujdes që nxënësit të jenë sa më aktivë dhe të mund t'i zhvillojnë vetë.					
15.2.6	Teksti shkollor ofron situata të nxëni (materiale, sugjerime dhe ushtrime) për secilën fazë, fushë dhe përmasë të nxënies.					
15.2.7	Në detyrat dhe udhëzimet, teksti shkollor u referohet, atje ku është e mundur, dukurive që gjenden në mjedisin real dhe në botën e nxënësve.					
15.2.8	Teksti shkollor u paraqet nxënësve probleme dhe metoda matematikore interesante, tërheqëse, duke ofruar mundësi dhe sugjerime për të nxënë në mënyrë kritike, kërkuese dhe të pavarur.					
15.2.9	Teksti shkollor, përmes situatave të nxënies, nxit te nxënësit					

	qëndrim të ndërgjegjshëm, kritik dhe reflektues ndaj matematikës në fushat e përdorimit të saj.					
15.2.10	Teksti shkollor zbaton parimet bashkëkohore të didaktikës së matematikës, si të nxënit në mënyrë aktive, ndërvepruese, vetëvepruese dhe zbuluese, orientim drejt procesit (jo rezultatit) etj.					
15.2.11	Teksti shkollor zhvillon kompetencat e nxënësve, duke u parashtruar detyra “të hapura”, detyra me më shumë se një rrugë zgjidhjeje ose duke i nxitur të përshkruajnë rrugën e ndjekur dhe të përdorin strategji vetjake.					
15.2.12	Teksti shkollor mundëson të nxënit në mënyrë të pavarur, p.sh., përmes formulimeve të thjeshta e të kapshme të detyrave (duke përdorur simbole të kuptueshme) dhe përmes situatave (tipave dhe formateve) të përdorura disa herë.					
15.2.13	Teksti shkollor ofron dije, strategji, ndihmë dhe teknika, lidhur me hapësirat e ndryshme të veprimit dhe të mendimit në fushën e matematikës.					
15.2.14	Teksti shkollor përmban, në sasi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, situata tërheqëse dhe motivuese në të cilat nxënësit ndërtojnë/demonstrojnë kompetencat matematikore.					
15.2.15	Teksti shkollor përmban sugjerime dhe pikënisje për nxënie që nxitin burimet e nxënësve, sidomos përmes sugjerimeve për integrimin dhe shfrytëzimin e njohurive matematikore (të ndërtuara tashmë ose njohuri jashtëshkollore).					
15.2.16	Situatat e nxënies (informacioni, detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme dhe ushtrimet), kudo ku është e mundur, nxitin ndërveprimin e nxënësve.					
15.2.17	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar dhe për mësim individual, duke ofruar detyra dhe ushtrime me nivele të ndryshme, të diferencuara sipas vështirësisë dhe sipas kërkesave.					
15.2.18	Në rastin e detyrave/ushtimeve me nivele të ndryshme (në kuptimin e punës së diferencuar), shkallët/nivelet e vështirësisë janë shënuar në mënyrë të kapshme/të dallueshme, që nxënësit të mund të orientohen në mënyrë të pavarur.					
15.2.19	Teksti shkollor krijon/tregon teknika dhe mënyra për vlerësimin ose vetëvlerësimin e rezultateve të të nxënit.					
Tregues të veçantë për tekstet e matematikës së arsimit fillor						
15.2.20	Përmes udhëzimeve, teksti shkollor siguron që fëmijët të kuptojnë herët natyrën (strukturën, ndërtimin), funksionet dhe mundësitë e matematikës. Mbi bazën e këtij kuptimi, proceset e të nxënit në lëndën “Matematikë” nxiten së brendshmi dhe shmangin të nxënit mekanik.					

15.2.21	Informacioni dhe numrat janë shkruar me shkrim që lexohet mirë e të përshtatshëm nga ana tipografike, me shkronja mjaft të mëdha dhe me largësi të mjaftueshme mes rreshtave: kjo për të lehtësuar orientimin e nxënësve në secilën faqe.					
15.2.22	Për fazën fillestare, kur nxënësit nuk zotërojnë ende të gjithë numrat dhe shkronjat, teksti shkollor ofron shumë fotografi, piktura etj., si dhe sugjerime përkatëse që nxitnin nxënësit të interesohen, të mendojnë, të komunikojnë me njëri-tjetrin për dukuritë matematikore.					
15.2.23	Teksti shkollor ofron situata të nxëni, materiale dhe sugjerime të mjaftueshme për të zhvilluar, njëkohësisht me kompetencat matematikore, edhe shkathtësi dhe strategji të posaçme të leximit dhe të shkrimit që janë me rëndësi për lëndën e matematikës.					

Vlera e standardit 15.2 = $\{15.2.1 + - + 15.2.19\} : 19 =$ _____

Për tekstet e matematikës së arsimit fillor:

Vlera e standardit = $\{15.2.1 + - + 15.2.23\} : 23 =$ _____

STANDARDI 15.3. SHKENCAT E NATYRËS

Standardi 15.3.1 Dituri natyre

Qëllimet: *Tekstet shkollore të lëndës “Dituri natyre”, klasat I-V, të luajnë rolin e një udhërrëfyesi dhe mjeti eksplorues që mundëson zhvillimin e kureshtjes, njohurive fillestare dhe aftësive bazë të procesit shkencor (vëzhgimi, krahasimi, grupimi/klasifikimi dhe matja e thjeshtë), duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë botën e gjallë dhe jo të gjallë që i rrethon (mjedisin e afërt), trupin e tyre, dukuritë e thjeshta të motit, materialet dhe forcat e përditshme. Tekstet shkollore të nxisin punën e pavarur përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë, aktiviteteve praktike dhe eksperimenteve të thjeshta e të sigurta. Tekstet shkollore të zhvillojnë shkathtësitë për të bërë pyetje, për të regjistruar të dhëna (me vizatime, tabela të thjeshta) dhe për t’i lidhur ato me jetën e përditshme, duke kultivuar qëndrime pozitive, respektin për mjedisin dhe kujdesin për shëndetin. Këtij qëllimi t’i shërbejnë udhëzimet e qarta, gjuha e përshtatshme për moshën, situatat tërheqëse dhe lojërat që nxisin të nxënësit aktiv përmes eksplorimit dhe ndëroepimit.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.3.1.1	Struktura didaktike (ndarja në tema, rubrika) është e qartë, e dallueshme vizualisht (me ikona, ngjyra) dhe e kuptueshme, duke lejuar orientim të lehtë për nxënësit e moshës 6-10 vjeç.					
15.3.1.2	Paraqitja e koncepteve (p.sh., gjallë/jo gjallë, dritë/hije, rritje/ndryshim) është e thjeshtë, shkencërisht e saktë dhe koherente me moshën e nxënësit.					
15.3.1.3	Teksti u referohet vazhdimisht dhe me kuptim dukurive natyrore dhe objekteve që gjenden në mjedisin e përditshëm e të afërt të nxënësit (shtëpi, klasë, oborr, park).					
15.3.1.4	Teksti zhvillon në mënyrë eksplicite aftësitë fillestare të procesit shkencor (vëzhgimin, krahasimin, grupimin/klasifikimin, parashikimin e thjeshtë) me anë të situatave konkrete e tërheqëse.					
15.3.1.5	Teksti siguron situata të larmishme të nxëni (vëzhgime, eksperimente të thjeshta, lojëra, detyra praktike) dhe është i përshtatshëm për punë të diferencuar, duke ofruar aktivitete me nivele të ndryshme vështirësie.					
15.3.1.6	Në fund të çdo njësie mësimore, kontrollohet arritja e rezultateve të të nxënit me kërkesa të përshtatura (p.sh., pyetje të thjeshta, detyra me vizatim, lidhje me shigjetë).					
15.3.1.7	Teksti u ofron nxënësve situata tërheqëse dhe sugjerime të qarta për të nxënë në mënyrë të pavarur përmes kërkimit dhe zbulimit (p.sh., “Gjej...”, “Eksploro...”).					
15.3.1.8	Teksti nxit strategji vetjake të nxënies dhe mënyra të ndryshme të të menduarit (p.sh., “Si mendon ti?”, “Pse ndodh kështu?”), bazuar në vëzhgimet dhe në aktivitetet praktike.					

15.3.1.9	Teksti përmban udhëzime të qarta për aktivitete praktike, eksperimente të thjeshta dhe vëzhgime në klasë ose në natyrë, të cilat janë thelbësore për lëndën.					
15.3.1.10	Teksti përmban aktivitete, detyra dhe vëzhgime që nxitin zbatimin e njohurive në jetën e përditshme (p.sh., lidhja e motit me veshjen, materialet dhe përdorimi i tyre).					
15.3.1.11	Detyrat, sugjerimet për aktivitete dhe eksperimentet e thjeshta nxitin komunikimin, punën në grup dhe ndërveprimin e nxënësve.					
15.3.1.12	Teksti u ofron nxënësve teknika të thjeshta për vetëvlerësim (p.sh., rubrika “Çfarë mësova?”, lista kontrolli me ikona), të përshtatshme për moshën.					
15.3.1.13	Ngarkesa (vëllimi) e njësive mësimore është e baraspeshuar, në përputhje me kohën mësimore dhe aftësitë perceptuese të moshës, duke shmangur ngarkesën e tepërt me tekst.					
15.3.1.14	Teksti ka një fjalorth të termave/koncepteve kryesore të shpjeguara thjesht, me shkronja të mëdha dhe, nëse është e mundur, me ilustrime.					
15.3.1.15	Në tekstin shkollor paraqiten në mënyrë të integruar rregulla të edukimit shëndetësor (higjiena, ushqimi) dhe përgjegjësisë mjedisore (kujdesi për bimët, kafshët, riciklimi).					
15.3.1.16	Teksti shkollor, përmes situatave dhe aktiviteteve të përshtatshme, nxit në mënyrë efektive zhvillimin e kompetencave lëndore të diturisë së natyrës.					
15.3.1.17	Teksti prezanton matje të thjeshta duke përdorur fillimisht njësi jo-standarde (p.sh., pëllëmbë) dhe më pas njësitë bazë (p.sh., metri, litri, °C) në kontekste të kuptueshme e praktike.					
15.3.1.18	Teksti përfshin udhëzime të qarta, të thjeshta dhe vizuale (me ikona) për sigurinë gjatë aktiviteteve praktike. Të gjitha materialet e sugjeruara janë të sigurta dhe shtëpiake.					
15.3.1.19	Teksti ofron shumë fotografi dhe ilustrime të qarta, realiste dhe tërheqëse, që nxitin vëzhgimin dhe shërbejnë si mjete mësimore funksionale, jo thjesht dekorative.					
15.3.1.20	Teksti siguron që nxënësit e kësaj grup-moshe të kuptojnë konceptet e integruara të shkencave (p.sh., proceset e thjeshta fizike, biologjike) dhe të përshkruajnë dukuritë natyrore (p.sh., moti, dita/nata, bota bimore/shtazore).					

Vlera e standardit = {[15.3.1 + - + 15.3.20] : 20} = ____

Standardi 15.3.2 Fizika

Qëllimet: *Tekstet shkollore të fizikës të mundësojnë zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve për të kuptuar dhe për të zbatuar dukuritë dhe ligjet e fizikës në natyrë dhe në situata të jetës së përditshme. Ato të lidhin teorinë me praktikën, duke i familjarizuar nxënësit me koncepte si materia, lëvizja, forcat dhe energjia, drita, tingulli, elektriciteti dhe magnetizmi, si dhe me fizikën hapësinore. Tekstet të ofrojnë një qasje të integruar që nxit mendimin kritik, krijues dhe kërkues, si dhe aftësinë për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e eksperimenteve. Ato duhet t'u mësojnë nxënësve të analizojnë të dhënat dhe të përdorin në mënyrë efektive burimet shkencore të informacionit. Përveç kësaj, tekstet duhet të nxisin punën e pavarur dhe bashkëpunuese, duke zhvilluar kuriozitetin dhe interesin për teknologjinë dhe përdorimin e platformave digjitale. Në këtë mënyrë, ato kontribuojnë në formimin e nxënësve si qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, të aftë të përdorin njohuritë shkencore për zhvillim të qëndrueshëm dhe përballimin e sfidave globale.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.3.2.1	Teksti shkollor paraqet situata të qarta dhe të kuptueshme të nxëni, me strukturë didaktike që siguron orientim të lehtë në përmbajtje dhe mbështet zbatimin efektiv të lëndës gjatë procesit mësimor.					
15.3.2.2	Teksti shkollor paraqet konceptet, dukuritë dhe ligjet e fizikës në mënyrë të saktë, të thjeshtë dhe të përshtatur me nivelin e nxënësve, duke ndihmuar në ndërtimin gradual të njohurive dhe të koncepteve fizike.					
15.3.2.3	Teksti shkollor reflekton arritjet më të reja shkencore dhe zhvillimet bashkëkohore në lëndën e fizikës, në përputhje me qasjen STEM dhe me kërkesat e programeve lëndore.					
15.3.2.4	Teksti shkollor shpjegon dhe përdor formula, veprime matematikore dhe analiza numerike përmes situatave praktike të të nxënit, duke orientuar nxënësit drejt arsytimit shkencor dhe zgjidhjes së pavarur të problemeve.					
15.3.2.5	Teksti shkollor ofron situata të larmishme të të nxënit (vëzhgime, hulumtime, ushtrime, detyra, eksperimente, punë praktike, demonstrime, simulime ndërvepruese dhe projekte kërkimore), të përshtatura sipas niveleve taksonomike, në funksion të zhvillimit të kompetencave të fizikës dhe të qasjes STEM.					
15.3.2.6	Teksti shkollor përmban në fund të çdo njësie mësimore kërkesa të qarta për vlerësimin e realizimit të rezultateve të të nxënit, të përcaktuara sipas niveleve të arritjes së kompetencave.					
15.3.2.7	Teksti shkollor përmban situata praktike të të nxënit (ushtrime dhe problema me zbatim formulash dhe situata konkrete nga					

	jeta e përditshme, eksperimente, demonstrime dhe projekte), që nxisin mendimin kritik, kreativitetin, zgjidhjen problemore dhe të nxënësve përmes kërkimit shkencor.					
15.3.2.8	Teksti shkollor paraqet metoda të ndryshme të të nxënësve përmes (provave, demonstrimeve, eksperimenteve, vëzhgimeve dhe hulumtimeve), duke inkurajuar nxënësit të zhvillojnë strategji të pavarura gjatë nxënies.					
15.3.2.9	Teksti shkollor mundëson përfshirjen aktive të nxënësve përmes eksperimenteve, punëve praktike, demonstrimeve, simulimeve ndërvepruese, vëzhgimeve në terren dhe vëzhgimeve astronomike në qiell të hapur, që të nxënë në mënyrë të pavarur në përputhje me moshën.					
15.3.2.10	Teksti shkollor përfshin një numër të mjaftueshëm ushtrimesh, detyrash, provash dhe eksperimentesh që mundësojnë thellimin e koncepteve, zbatimin praktik dhe lidhjen e fizikës me situata reale, përmes përdorimit të teknologjisë.					
15.3.2.11	Teksti shkollor inkurajon komunikimin dhe bashkëpunimin e nxënësve përmes punës në grup, projekteve të përbashkëta dhe aktiviteteve për zgjidhjen e problemeve shkencore me ide inovative.					
15.3.2.12	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar, duke ofruar detyra, ushtrime dhe eksperimente me nivele të ndryshme vështirësie, për të mbështetur nevojat individuale të nxënësve.					
15.3.2.13	Teksti shkollor u ofron nxënësve teknika dhe mënyra për vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe të rezultateve të të nxënësve.					
15.3.2.14	Teksti shkollor siguron një ngarkesë mësimore të balancuar dhe koherente në çdo njësi, në përputhje me rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në program dhe me zhvillimin e kompetencave lëndore të nxënësve.					
15.3.2.15	Teksti shkollor përmban ushtrime dhe detyra, përmbajtja e të cilave përshtatet me shembuj nga vendbanimi dhe mjedisi ku jetojnë nxënësit.					
15.3.2.16	Teksti shkollor përmes materialeve të larmishme (ushtrime, prova, eksperimente dhe platforma ndërvepruese), nxit zhvillimin e kompetencave shkencore, teknologjike, inxhinierike dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve.					
15.3.2.17	Teksti shkollor përmban përmbajtje që nxitin edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e mjedisit, duke përdorur konceptet fizike për të mbështetur përdorimin efikas të energjisë së ripërtëritshme dhe burimeve natyrore.					
15.3.2.18	Teksti shkollor përmban përmbajtje që mbështet edukimin					

	shëndetësor dhe sigurinë, duke trajtuar përdorimin e sigurt të elektricitetit dhe valëve elektromagnetike, mbrojtjen nga rrezatimet gjatë diagnostikimeve mjekësore, ekspozimin ndaj diellit dhe mbrojtjen e dëgjimit nga valët zanore me frekuenca jashtë kufijve të lejueshëm.					
15.3.2.19	Në fund të tekstit shkollor paraqitet një fjalorth i madhësive fizike, me simbolet dhe njësitë matëse të tyre, në përputhje me standardin ndërkombëtar (SI).					
15.3.2.20	Teksti shkollor përdor një fjalor terminologjik të saktë dhe të unifikuar për madhësitë fizike, simbolet, formulat dhe njësitë matëse, në përputhje me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) dhe me terminologjinë e programit lëndor.					

Vlera e standardit = $\{[15.3.2.1 + - + 15.3.2.20] : 20\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 15.3.3 Kimia

Qëllimet: *Tekstet shkollore të lëndës së kimisë përbëjnë mjete bazë didaktike dhe shkencore, të cilat mundësojnë ndërtimin e qëndrueshëm të njohurive rreth strukturës, përbërjes dhe transformimeve të materies, si dhe zhvillimin e kompetencave shkencore të nxënësit. Tekstet i ndihmojnë nxënësit të krijojnë vetëdijen për vrojtimin në natyrë të dukurive fizike dhe kimike, si dhe për unitetin e materies. Tekstet shkollore i ndihmojnë nxënësit në punën e pavarur teorike, eksperimentale dhe praktike, në zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive për të matur, për të përpunuar të dhëna eksperimentale dhe për t'i zbatuar në situata konkrete, për zhvillimin e mendimit kritik e krijues dhe zgjidhjes problemore, si dhe për të përdorur literaturë dhe burime të tjera për nxënie. Këtij qëllimi t'i shërbejnë udhëzimet e tekstit shkollor në lidhje me strategjitë e të nxënësit, si dhe përgatitja, hartimi dhe paraqitja e situatave të reja, që ato të ndihmojnë dhe të nxitin të nxënësit aktiv përmes ndëroveprimit. Përfshirja e teknologjisë si simulimet virtuale, laboratorët digjitalë, platformat ndërovepruese dhe burimet digjitale, zgjeron më tej gamën e përvojave të nxënësit, duke bërë të mundur ndëroveprimin aktiv të nxënësit me përmbajtjen shkencore dhe zhvillimin e kompetencave shkencore në një mjedis të integruar digjital.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.3.3.1	Situatat e të nxënësit dhe struktura didaktike e tekstit shkollor janë të qarta, të kuptueshme, lejojnë orientimin e lehtë në tekst dhe zbatimin e lëndës së trajtuar gjatë mësimin.					
15.3.3.2	Format, mënyrat dhe ecuritë e paraqitjes së ligjshmërive janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
15.3.3.3	Teksti shkollor u referohet arritjeve të reja shkencore.					
15.3.3.4	Ndërtimi i formulave, i veprimeve matematike dhe i analizave numerike, ndërtohet me anën e situatave dhe zhvillohet në mënyrë të kujdesshme, jo imponuese, që nxënësit të jenë sa më aktivë dhe të mund të veprojnë të pavarur.					

15.3.3.5	Teksti shkollor siguron situata të larmishme të të nxënit (materiale, prova, ushtrime, detyra dhe eksperimente), të përshtatura për secilin nivel taksonomik, me synim zhvillimin e kompetencave shkencore të nxënësve					
15.3.3.6	Teksti përmban aparat pedagogjik me kërkesa të përcaktuara që u drejtohen nxënësve në funksion të përmbushjes së rezultateve të të nxënit, për çdo njësi mësimore dhe nivel të nxëni.					
15.3.3.7	Teksti shkollor u ofron nxënësve situata të nxëni (problema, metoda njehsimi, zgjidhje interesante dhe tërheqëse), por dhe mundësi e sugjerime të ndryshme për të nxënë të pavarur, nëpërmjet kërkimit e zbulimit.					
15.3.3.8	Në tekstin shkollor paraqiten mënyra të ndryshme të arritjes së të njëjtit përfundim, i cili nxirret nga prova, demonstrime, matje eksperimentale, vërtetime dhe zgjidhje detyrash me ecuri të ndryshme, të cilat nxisin zhvillimin e strategjive vetjake të të nxënit.					
15.3.3.9	Teksti shkollor përmban në sasi të mjaftueshme ushtrime, detyra, prova, demonstrime, eksperimente që nxitin dhe mundësojnë thellimin dhe zbatimin në jetën e përditshme të njohurive dhe të kompetencave të fituara.					
15.3.3.10	Në tekstin shkollor, detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet, provat, demonstrimet dhe eksperimentet nxitin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve.					
15.3.3.11	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar me nxënësit dhe për nxënie individuale, pasi ofron detyra, ushtrime, prova, demonstrime, eksperimente dhe vërtetime të niveleve të ndryshme, sipas vështirësisë dhe kërkesave.					
15.3.3.12	Teksti shkollor u ofron nxënësve, teknika dhe mënyra për vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe të rezultateve të të nxënit.					
15.3.3.13	Ngarkesat (vëllimi) e njësive mësimore në tekstin shkollor janë të baraspeshuara mes tyre, në përputhje me lëndën dhe me kompetencat e nxënësve.					
15.3.3.14	Në fund të tekstit shkollor është fjalorthi i termave të koncepteve kryesore të trajtuara, si dhe indeksi i termave shkencorë.					
15.3.3.15	Në tekstin shkollor, detyrat, provat, demonstrimet, eksperimentet, matjet e thjeshta, vërtimet në qiell u referohen, vazhdimisht dhe me kuptim, dukurive natyrore që gjenden në mjedisin jetësor dhe në botën e nxënësve.					
15.3.3.16	Në tekstin shkollor, korniza e përmbajtjes, e simboleve dhe e formulave kimike, si dhe emërtimi i tyre është në përputhje me					

	sistemin ndërkombëtar të njësive (SI) dhe rregullave të IUPAC-ut.					
15.3.3.17	Teksti shkollor përfshin udhëzime të plota për sigurinë teknike gjatë provave, demonstrimeve, eksperimenteve, si dhe katalogun e materialeve të rrezikshme, duke garantuar praktika të sigurt dhe të standardizuara mësimore.					
15.3.3.18	Teksti shkollor ofron shumë fotografi, eksperimente, grafikë që nxitin nxënësit të interesohen, të mendojnë e të komunikojnë me njëri- tjetrin për mjedisin që i rrethon, dukuritë natyrore, proceset industriale dhe ndikimin e digjitalizimit dhe në fushën e shkencës.					
15.3.3.19	Teksti shkollor ofron materiale të bollshme dhe ilustrime me situata reale të jetës, të cilat e ndihmojnë nxënësin të lidhë përmbajtjen e kimisë me proceset kimike, ato industriale dhe me zbatimet praktike në jetën e përditshme.					
15.3.3.20	Teksti shkollor, përmes situatave të nxënies, nxit te nxënësit qëndrim të ndërgjegjshëm, kritik dhe reflektues ndaj shkencës së kimisë në fushat e përdorimit të saj.					
15.3.3.21	Teksti shkollor ofron ushtrime me nivele të ndryshme vështirësie (në funksion të punës së diferencuar). Shkallët e vështirësisë janë të dallueshme, në mënyrë që nxënësit të orientohen vetë në zgjidhjen e detyrave.					

Vlera e standardit = {[15.3.1 + - + 15.3.21] : 21} = ____

Standardi 15.3.4 Biologjia

Qëllimet: *Tekstet shkollore të biologjisë të mundësojnë zhvillimin e njohurive dhe kompetencave të nxënësve për studimin e aspekteve të ndryshme të botës së gjallë dhe të marrëdhënieve të tyre me mjedisin. Ato duhet të ndihmojnë nxënësit të krijojnë vetëdijen për ndërtimin dhe funksionimin e organizmave të gjallë në të gjitha nivelet, ligjësitë e proceseve jetësore, unitetin e materies organike dhe vendin e njeriut në biosferë. Tekstet shkollore të ndihmojnë nxënësit në punën e pavarur teorike, eksperimentale, praktike dhe në terren, në zhvillimin e shkathtësive dhe shprehive për të matur, për të përpunuar të dhëna eksperimentale dhe për t'i zbatuar ato në situata konkrete. Tekstet e biologjisë duhet të nxisin zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, zgjidhjen problemore, si dhe aftësinë për të përdorur literaturë shkencore dhe burime të tjera për nxënie. Këtij qëllimi t'i shërbejnë udhëzimet e tekstit në lidhje me strategjitë e të nxënësve, si dhe hartimi dhe paraqitja e situatave të reja që nxitin të nxënësit aktiv përmes ndërveprimit dhe hulumtimit.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.3.4.1	Teksti ofron përmbajtje të saktë shkencore, koherente dhe të përditësuar në përputhje me arritjet e reja shkencore.					

15.3.4.2	Tekstit shkollor ka strukturë didaktike të qartë, të kuptueshme, që lejon orientimin e lehtë në tekst dhe zbatimin e lëndës së trajtuar gjatë mësimin.					
15.3.4.3	Teksti shkollor ndihmon në ndërtimin dhe në zhvillimin e kompetencave shkencore duke ofruar udhëzime për përdorimin e metodave shkencore, përfshirë formulimin e hipotezave/ pyetjeve shkencore, bazuar në njohuritë paraprake, matjen, përpunimin e të dhënave dhe reflektimin mbi rezultatet.					
15.3.4.4	Teksti përfshin situata ose detyra që kërkojnë nga nxënësit të bëjnë parashikime të argumentuara shkencërisht, duke inkurajuar përdorimin krijues të njohurive.					
15.3.4.5	Teksti përmban udhëzime se si të komunikohen rezultatet shkencore (përmes prezantimeve dhe diskutimeve) duke përdorur efektivisht mjete pamore (diagramë, grafikë, tabela), dhe siguruar që informacioni të transmetohet në mënyrë të saktë dhe tërheqëse.					
15.3.4.6	Teksti përmban aparat pedagogjik me kërkesa të përcaktuara që u drejtohen nxënësve në funksion të përmbushjes së rezultateve të të nxënësve, për çdo njësi mësimore dhe nivel të nxënësit.					
15.3.4.7	Teksti shkollor u ofron nxënësve situata të nxënësit (problema, metoda njehsimi, zgjidhje interesante, tërheqëse), por dhe mundësi e sugjerime të ndryshme për të nxënësit në mënyrë të pavarur, nëpërmjet kërkimit e zbulimit.					
15.3.4.8	Teksti shkollor siguron lidhje të shumfishta midis koncepteve shkencore e metodologjike dhe ndërlidhet me konceptet e lëndëve të përafërta, si bazë për ndërtimin nga nxënësit të njohurive të reja dhe të kompetencave.					
15.3.4.9	Në tekstin shkollor paraqiten mënyra të ndryshme të arritjes së të njëjtit përfundim, i cili nxirret nga prova, demonstrime, matje eksperimentale, vërtetime dhe zgjidhje detyrash me ecuri të ndryshme, të cilat nxënësin zhvillimin e strategjive vetjake të të nxënësit.					
15.3.4.10	Teksti shkollor ofron dije procedurale, strategji dhe teknika, bazuar në mënyrën sistematike dhe logjike të mendimit që përdoret nga shkencëtarët për të zbuluar dhe interpretuar botën e gjallë, përfshirë logjikën analitike dhe aftësinë për të ndërtuar njohuri mbi dëshmi empirike.					
15.3.4.11	Teksti shkollor përmban në sasi të mjaftueshme ushtrime, detyra, prova, demonstrime, eksperimente që nxënësin dhe mundësojnë thellimin dhe zbatimin në jetën e përditshme të njohurive biologjike dhe të kompetencave të fituara.					
15.3.4.12	Në tekstin shkollor, detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme,					

	ushtrimet, provat, demonstrimet dhe eksperimentet nxitin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve.					
15.3.4.13	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar me nxënësit dhe për nxënie individuale, pasi ofron detyra, ushtrime, prova, demonstrime, eksperimente dhe vëzhgime të niveleve të ndryshme të vështirësisë dhe kërkesave.					
15.3.4.14	Teksti shkollor u ofron nxënësve, teknika dhe mënyra për vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe të rezultateve të nxënies.					
15.3.4.15	Ngarkesat e njësive mësimore në tekstin shkollor janë të baraspeshuara mes tyre, në përputhje me lëndën dhe me moshën e nxënësve.					
15.3.4.16	Në fund të tekstit shkollor është fjalorthi i termave të koncepteve kryesore të trajtuara, si dhe indeksi i termave shkencorë.					
15.3.4.17	Në tekstin shkollor, detyrat, provat, demonstrimet, eksperimentet, matjet e thjeshta, vëzhgimet u referohen vazhdimisht dhe me kuptim, dukurive biologjike që mund të hetohen drejtpërdrejt në mjedisin jetësor të nxënësve.					
15.3.4.18	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e edukimit shëndetësor dhe të ruajtjes së mjedisit.					
15.3.4.19	Teksti shkollor përfshin udhëzime të plota për sigurinë teknike gjatë provave, demonstrimeve, eksperimenteve dhe vëzhgimeve në natyrë, si dhe katalogun e materialeve të rrezikshme, duke garantuar praktika të sigurta dhe të standardizuara mësimore.					

Vlera e standardit 15.3.4 = {[15.3.4.1 + - + 15.3.4.19] :19} = ____

STANDARDI 15.4. SHKENCAT SHOQËRORE

15.4.1 Historia

Qëllimet: *Tekstet shkollore të historisë të shërbejnë si mbështetje e qartë dhe transparente për atë që nxënësit duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë. Ato t'i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë zhvillimet, proceset dhe dukuritë e shoqërisë njerëzore, duke formuar vetëdijen historike. Tekstet shkollore të historisë të kontribuojnë në zhvillimin e njohurive, të koncepteve dhe të kompetencave të nxënësve për përdorimin e metodave kërkimore, për gjykimin kritik e krijues të burimeve dhe të pikëpamjeve të ndryshme, si dhe për zbatimin e tyre në procesin e marrjes së vendimeve. Po ashtu, ato duhet të nxisin formimin e nxënësve si qytetarë aktivë, krijues, të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm, të aftë për të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në ndërtimin e një shoqërie demokratike.*

Tekstet të ofrojnë mënyra të ndryshme prezantimi të përmbajtjes mësimore, të lehtësojnë pjesëmarrjen dhe angazhimin e të gjithë nxënësve, si dhe të mundësojnë mënyra të ndryshme të të nxënësve, duke respektuar diversitetin e aftësive, stileve të të nxënësve dhe nevojave individuale.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.4.1.1	Teksti shkollor, në aspektin didaktik, ndërtohet mbi përvojat dhe njohuritë e mëparshme të nxënësve, duke i përdorur ato si pikënisje për kuptimin dhe zhvillimin e koncepteve të reja.					
15.4.1.2	Teksti shkollor krijon lidhje të drejtpërdrejta me jetën e përditshme të nxënësve, duke e bërë përmbajtjen dhe përvojën e të nxënësve më kuptimplotë, funksionale dhe të zbatueshme në situata konkrete.					
15.4.1.3	Teksti shkollor nxit të nxënësve të qartë dhe siguron lidhje të drejtpërdrejta ndërmjet përmbajtjes, kompetencave lëndore dhe kompetencave kyç.					
15.4.1.4	Struktura e ndërtimit të tekstit shkollor është e qartë, e kuptueshme dhe lejon orientim të shpejtë e të lehtë, si dhe zbatimin aktiv të njohurive të trajtuara gjatë procesit të nxënies.					
15.4.1.5	Teksti shkollor ndihmon zhvillimin e aftësive të nxënësve për të qenë qytetarë të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e një shoqërie demokratike.					
15.4.1.6	Përmes materialeve, pyetjeve dhe sugjerimeve, teksti shkollor nxit nxënësit të kultivojnë vlera si mirëkuptimi, bashkëpunimi, toleranca, pagja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si faktorë vendimtarë të pajtimit, mirënjohjes dhe besimit të ndërsjellë midis njerëzve e popujve.					
15.4.1.7	Teksti shkollor respekton veçantitë etnike dhe kulturore të Shqipërisë dhe kontribuon në kultivimin e identitetit					

	individual, kolektiv e kombëtar, përmes njohjes së trashëgimisë historike e kulturore në nivel lokal, rajonal, kombëtar, evropian dhe botëror.					
15.4.1.8	Teksti shkollor pasqyron larminë, kohezionin dhe integrimin e grupeve dhe të kategorive shoqërore (gjinore, etnike, racore, fetare etj.), si dhe konkretizon një qasje ndërkulturore që paraqet ngjarjet historike nga këndvështrime të ndryshme.					
15.4.1.9	Teksti shkollor ofron strategji dhe metoda mësimore të lidhura me çështjet shoqërore-historike dhe me temat me të cilat përballet shoqëria e shekullit XXI, duke nxitur reflektimin kritik dhe mendimin historik.					
15.4.1.10	Teksti shkollor përmban pyetje, ushtrime dhe veprimtari praktike, tërheqëse, motivuese dhe të përshtatshme për moshën, të cilat nxisin zhvillimin e koncepteve, kërkimin, përdorimin e burimeve dhe analizën e ngjarjeve historike, si dhe interpretimin e tyre në mënyrë kritike e analitike.					
15.4.1.11	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar, përmes të cilës nxënësit ndërmarrin kërkime individuale (sipas nivelit, mundësive dhe rrethanave), dhe nxit kërshtërinë, aftësitë e vlerësimit e vetëvlerësimit, si dhe mendimin kritik e krijues të nxënësve.					
15.4.1.12	Hartat, ilustrimet, fotot, karikaturat, tabelat statistikore dhe burimet paraqiten në mënyrë të qartë e të kuptueshme. Ato mbështesin procesin e të kuptuarit dhe analizës së ngjarjeve e dukurive historike, si edhe nxisin komunikimin dhe ndërveprimin mes nxënësve. Përdorimi i tyre respekton parimin e mosdiskriminimit.					
15.4.1.13	Teksti shkollor krijon ndërthurje të balancuar ndërmjet përdorimit të praktikave dhe metodologjive bashkëkohore, duke integruar TIK-un, inteligjencën artificiale (IA), mjetet multimediale si edhe mundësitë që ofrojnë muzetë dhe arkivat.					
15.4.1.14	Teksti shkollor siguron integrimin ndërlëndor dhe zhvillimin e temave ndërkurrikulare, duke vendosur lidhje me fushat e tjera të të nxënit ose lëndët si letërsia, gjeografia, shkencat shoqërore, filozofia, artet dhe shkencat e natyrës.					
15.4.1.15	Teksti shkollor paraqet situata të nxëni që e vënë ngjarjen historike në veprim, nxisin propozimin e zgjidhjeve dhe e vendosin atë në kontekstin shoqëror, politik, ekonomik dhe kulturor të kohës.					
15.4.1.16	Teksti shkollor nxit zhvillimin e empatisë historike, duke u mundësuar nxënësve të kuptojnë përvojat, motivimet dhe këndvështrimet e njerëzve në periudha të ndryshme historike.					
15.4.1.17	Gjuha e përdorur në situatat e nxënies përshtatet me moshën e nxënësve.					

15.4.1.18	Teksti shkollor ofron mënyra dhe teknika për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe rezultateve të të nxënësve nga nxënës.					
-----------	---	--	--	--	--	--

Vlera e standardit 15.4.1 = {[15.4.1.1 + - + 15.4.1.18] :18} = ____

15.4.2 Qytetaria

Qëllimet: Teksti shkollor i qytetarisë të nxisë zhvillimin e nxënësve si qytetarë të ndërgjegjshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, të pajisur me njohuri, vlera dhe qëndrime të qytetarisë demokratike; qytetarë paqësorë, tolerantë, të hapur dhe të gatshëm për të marrë pjesë në jetën qytetare të vendit dhe për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie ku respektohen të drejtat e çdo individi, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, kombëtare, etnike, fetare dhe racore.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.4.2.1	Teksti shkollor ndihmon në zhvillimin dhe zgjerimin e kompetencave personale dhe qytetare.					
15.4.2.2	Teksti shkollor është koherent sa i takon konceptimit didaktik, terminologjisë së përdorur dhe mënyrës së paraqitjes së çështjeve të edukimit qytetar.					
15.4.2.3	Format dhe përmbajtjet e situatave të nxënies janë të qarta, funksionale dhe koherente me qëllimet e parashikuara në programin lëndor.					
15.4.2.4	Ndërtimi dhe struktura e tekstit shkollor janë të qarta, të kapshme dhe lejojnë orientimin e lehtë dhe zbatimin e nxëniesve të trajtuara.					
15.4.2.5	Ilustrimet, fotografitë, statistikën, grafikët, kutitë ose komentet e veçanta japin informacion plotësues që ndihmojnë procesin e të nxënësve përmes komunikimit dhe ndërveprimit.					
15.4.2.6	Teksti shkollor ndihmon kuptimin e qytetarisë demokratike, duke krijuar hapësirë për punë të pavarur dhe duke nxitur kureshtjen për shfrytëzimin e burimeve të shkruara dhe/ose elektronike, ose nga bisedat me qytetarë, me anëtarë ose me drejtues të shoqatave, institucioneve etj.					
15.4.2.7	Teksti shkollor u referohet strukturave, ngjarjeve dhe institucioneve shoqërore dhe u jep mundësi nxënësve të përballen më lehtë dhe të zgjidhin çështje me të cilat merren ata dhe komuniteti ku jetojnë.					
15.4.2.8	Përmes shkrimeve, sugjerimeve dhe detyrave të përshtatshme, teksti shkollor nxit dhe përgatit nxënësve për qëndrime të ndërgjegjshme, kritike dhe reflektuese ndaj problemeve shoqërore, për marrjen e përgjegjësisë dhe të detyrave në familje, në shkollë apo në komunitet.					

15.4.2.9	Teksti shkollor, me shpjegime dhe me shembuj të përshtatshëm, nxit pjesëmarrjen aktive dhe vendimmarrjen në çështjet që kanë të bëjnë me të mirën dhe interesin personal e publik.					
15.4.2.10	Teksti shkollor përmban informacion mbi vlerat dhe konceptet themelore të qytetarisë, nxit pjesëmarrjen në organizimet e jetës shoqërore dhe komunikimin/ndërveprimin në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.					
15.4.2.11	Teksti shkollor ndikon drejtpërdrejt ose tërthorazi në edukimin për demokraci dhe vlera të shoqërisë demokratike, për të drejtat njerëzore, për barazi qytetare, për luftë kundër dallimit gjinor, kulturor, gjuhësor, etnik, racor, fetar etj.					
15.4.2.12	Teksti shkollor kultivon qëndrime dhe vlera humane dhe mjedisore, rrit vetëdijen dhe nxit veprime që synojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe të mjedisit.					
15.4.2.13	Teksti shkollor afirmon paqen, tolerancën, mirëkuptimin, komunikimin, dialogun dhe solidaritetin ndërmjet brezave, kulturave, feve, etnive dhe kombeve të ndryshme.					
15.4.2.14	Teksti shkollor promovon vlerat për zhvillimin e identitetit vetjak, për kujdesin dhe ruajtjen e shëndetit nga të gjitha format e rrezikut, nëpërmjet shkathtësive për jetën, duke gjetur format e parandalimit të konflikteve ose të zgjidhjes paqësore të tyre.					
15.4.2.15	Gjuha e përdorur në situatat e nxënies përshtatet me moshën dhe aftësitë e nxënësve.					
15.4.2.16	Teksti shkollor jep mundësi dhe ofron mënyra e teknika për vetëvlerësimin e rezultateve të nxënies nga nxënësit.					

Vlera e standardit 15.4.2 = {[15.4.2.1 + ... + 15.4.2.16] : 16} = ____

15.4.3 Gjeografia

Qëllimet: *Tekstet shkollore të gjeografisë të mundësojnë zhvillimin e njohurive dhe të kompetencave të nxënësve për studimin e tipareve natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, proceseve dhe dukurive gjeografike, për studimin e diversitetit të vendeve dhe rajoneve, ndëroarësisë dhe ndërveprimit midis tyre, si dhe marrëdhëniet e njeriut me mjedisin, në nivel lokal, rajonal dhe botëror. Tekstet shkollore të gjeografisë të ndihmojnë nxënësit në punën e pavarur, në punën në grup, në zhvillimin e shkathtësive për të zbatuar njohuritë në situata konkrete, në zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues dhe shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të të nxënësve. Tekstet shkollore të gjeografisë të nxitin zhvillimin e nxënësve si qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm për ndërtimin e një shoqërie demokratike.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.4.3.1	Teksti shkollor u përshtatet aftësive njohëse, njohurive të ndërtuara paraprakisht nga nxënësit, nevojave dhe interesave					

	të tyre.					
15.4.3.2	Për sa i përket konceptimit didaktik, terminologjisë së përdorur dhe mënyrës si paraqiten çështjet e trajtuara, teksti shkollor përputhet plotësisht me filozofinë dhe qëllimet e programit përkatës.					
15.4.3.3	Teksti shkollor kontribuon në procesin e të nxënit dhe përmban situata të nxëni, udhëzime, sugjerime, burime që mbështesin të nxënit e pavarur, të nxënit në bashkëpunim, hulumtimin dhe zhvillimin e kompetencave.					
15.4.3.4	Teksti shkollor përfshin veprimtari që lidhin përmbajtjen gjeografike me jetën reale, duke nxitur orientimin me hapësirën dhe mjedisin që na rrethon, përdorimin praktik të njohurive dhe duke mbështetur orientimin drejt karrierës dhe tregut të punës.					
15.4.3.5	Teksti shkollor nxit interesin për gjeografinë dhe shkathtësitë e mendimit kritik dhe krijues.					
15.4.3.6	Teksti shkollor nxit zhvillimin e lidhjeve ndërlëndore të gjeografisë me fushat e tjera të të nxënit, duke vendosur lidhje me historinë, qytetarinë, gjuhën, letërsinë, STEM etj.					
15.4.3.7	Teksti shkollor zhvillon ndjenjën e dashurisë ndaj vendit tonë dhe afirmon njohjen, respektimin dhe hapjen ndaj vlerave të popujve, kombeve dhe kulturave të tjera në Evropë dhe në botë.					
15.4.3.8	Përmes materialeve, pyetjeve, sugjerimeve dhe veprimtarive të ndryshme, teksti shkollor nxit nxënësit të kultivojnë vlera si mirëkuptimi, bashkëpunimi, toleranca, gjithëpërfshirja, empatia, pagja, respekti, mirëkuptimi dhe besimi i ndërsjellë midis njerëzve e popujve.					
15.4.3.9	Teksti shkollor mundëson lidhjet e lëndës së gjeografisë me temat ndërkurrikulare, si identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, teknologjia, shoqëria dhe media etj.					
15.4.3.10	Teksti shkollor kultivon qëndrime dhe vlera humane dhe mjedisore, rrit vetëdijen dhe nxit veprime që synojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe të mjedisit.					
15.4.3.11	Teksti shkollor nxit mendimin e pavarur, zhvillon shkathtësitë hulumtuese në lëndën e gjeografisë dhe ndihmon zhvillimin e cilësive pozitive të personalitetit.					
15.4.3.12	Teksti shkollor ndihmon të kuptuarit e proceseve dhe dukurive gjeografike në Tokë, bashkëveprimet të ndërsjellë midis sistemeve fiziko-gjeografike, sociale dhe ekonomike në					

	nivel lokal, rajonal dhe global, të kuptuarit e diversitetit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit, progresit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.					
15.4.3.13	Struktura e ndërtimit të tekstit shkollor është e qartë dhe lejon orientim të shpejtë, të lehtë dhe zbatimin aktiv të njohurive të trajtuara gjatë procesit të nxënies.					
15.4.3.14	Hartat gjeografike në tekstin shkollor janë të lexueshme (kanë madhësinë e duhur për t'u lexuar) dhe kanë kontrast të mjaftueshëm të ngjyrave.					
15.4.3.15	Hartat skicë, ilustrimet, fotografitë, statistikën, grafikët dhe burimet digjitale të përfshira në tekstin shkollor mbështesin procesin e të nxënies, zhvillimin e mendimit gjeografik dhe nxisin komunikimin, ndërveprimin, si dhe aftësitë analitike të nxënësve.					
15.4.3.16	Teksti shkollor krijon lidhje harmonike ndërmjet përdorimit të praktikave dhe të metodologjive bashkëkohore, TIK-ut multimedial, vëzhgimeve në natyrë.					
15.4.3.17	Ngarkesat (vëllimi) e njësive mësimore në tekstin shkollor janë të baraspeshuara mes tyre, në përputhje me lëndën dhe me kompetencat e nxënësve.					
15.4.3.18	Teksti shkollor ofron strategji dhe instrumente për vlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe të rezultateve të nxënies, si dhe për vetëvlerësimin nga nxënësit.					

Vlera e standardit 15.4.3 = {[15.4.3.1 + - + 15.4.3.18] : 18} = ____

15.4.4 Shkencat e tjera sociale dhe filozofia

Qëllimet: Teksti shkollor të përmbajë njohuri themelore nga lënda përkatëse dhe të shpjegojë proceset dhe dukuritë shoqërore, mbështetur në teoritë shkencore të përparuara. Teksti shkollor të përputhet me qëllimet e lëndës, duke shmangur njëanshmëritë në paraqitje dhe në interpretime, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.4.4.1	Teksti u përshtatet aftësive njohëse, njohurive të ndërtuara paraprakisht nga nxënësit, nevojave dhe interesave të nxënësit; pamja dhe paraqitja e tekstit shkollor përputhet me moshën e nxënësve për të cilët është konceptuar ai.					
15.4.4.2	Për sa i përket konceptimit didaktik, terminologjisë së përdorur dhe mënyrës si paraqiten çështjet e trajtuara, teksti shkollor është koherent dhe përputhet plotësisht me konceptimin e përgjithshëm të qasjes që bazohet në kompetenca dhe me qëllimet e programit përkatës.					

15.4.4.3	Teksti shkollor është strukturuar në përputhje me dijet, me metodologjinë e disiplinës/lëndës përkatëse dhe qartëson çka duhet të mësojë nxënësi dhe cilat janë rezultatet e të nxënit.					
15.4.4.4	Teksti shkollor kontribuon në procesin e të nxënit dhe përmban situata të nxëni (materiale, udhëzime, sugjerime dhe nxitje për nxënie të pavarur, informacione e të dhëna bibliografike për libra dhe burime plotësuese) për thellimin e njohurive dhe të kompetencave nga lënda përkatëse.					
15.4.4.5	Teksti shkollor nxit interesin për lëndën mësimore, duke krijuar jo vetëm qëndrim pozitiv ndaj përmbajtjes së lëndës, por motivon edhe aftësitë e mendimit kritik dhe krijues.					
15.4.4.6	Teksti shkollor zhvillon lidhje të shumëfishta midis koncepteve shkencore dhe ndërlihet me konceptet e lëndëve të përfaqësuara, si bazë për ndërtimin nga nxënësit të njohurive të reja dhe të kompetencave.					
15.4.4.7	Teksti shkollor mbështetet në teori shkencore dhe në parime morale të kuptueshme dhe të pranueshme, zbatimi i të cilave është në pajtim me shkallën e zhvillimit të nxënësit.					
15.4.4.8	Teksti shkollor shpalos ide, vlera dhe parime morale, duke ndihmuar ndërgjegjësimin për ndryshimet sociale, kulturore, ekonomike dhe mjedisore që ndërlihen me zhvillimin shkencor dhe teknologjik.					
15.4.4.9	Teksti shkollor mbështetet në njohjen dhe në studimin e kushteve të përgjithshme të ekzistencës dhe të zhvillimit të njeriut dhe të shoqërisë njerëzore, të zhvillimit të kulturës së popujve dhe të vendeve të ndryshme, të ruajtjes së mjedisit, të ekosistemeve dhe të biodiversitetit.					
15.4.4.10	Teksti shkollor nxit mendimin të pavarur, kritik dhe krijues, zhvillon shkathtësitë hulumtuese në fushën e lëndës përkatëse dhe ndihmon zhvillimin e cilësive pozitive të personalitetit.					
15.4.4.11	Teksti shkollor nxit qëndrime, sjellje të dobishme dhe funksionale (vetjake dhe kolektive) dhe forcon frymën e bashkëpunimit, integritetit dhe gjithëpërfshirjes.					
15.4.4.12	Teksti shkollor ndihmon të kuptuarit e proceseve të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, ndarjen shoqërore të punës, ekonominë, shtresat dhe lëvizjet sociale, politikën, kohezionin, si dhe integritetin social, progresin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.					
15.4.4.13	Teksti shkollor shpalos vlerat dhe parimet e demokracisë dhe të sundimit të ligjit dhe mbështet zhvillimin demokratik dhe pluralist të shoqërisë.					
15.4.4.14	Teksti shkollor u kundërvihet diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe paraqitjes negative të individëve dhe të grupeve shoqërore.					

15.4.4.15	Teksti shkollor afirmon dhe ndihmon njohjen e proceseve integruese evropiane, në të gjitha fushat e jetës shoqërore.					
15.4.4.16	Teksti shkollor zhvillon ndjenjën e dashurisë ndaj vendit tonë si bashkësi e qytetarëve të barabartë dhe afirmon njohjen, respektimin dhe hapjen ndaj vlerave të popujve, kombeve dhe kulturave të tjera në Evropë dhe në botë.					

Vlera e standardit 15.4.4 = {[15.4.4.1 + - + 15.4.4.16] : 16} = ____

STANDARDI 15.5. ARTET

15.5.1 Muzika

Qëllimet: Teksti shkollor të përmbajë njohuri themelore të muzikës në nivele/ klasa të ndryshme shkollimi, duke qenë udhërrëfyes për mësuesin e muzikës në realizimin e qëllimeve të lëndës. Teksti shkollor të jetë mjet i nevojshëm për punë individuale, punë në grup në klasë dhe për punë të pavarur në shtëpi. Teksti shkollor të jetë i plotë, i përdorshëm dhe të shoqërohet me burime didaktike muzikore përkatëse. Teksti shkollor të konceptohet në njësi mësimore, të cilat përmbajnë situata (ushtrime dhe kombinime të veprimtarive specifike muzikore), që ndihmojnë nxënësin të zhvillojë kompetencat e lëndës.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.5.1.1	Teksti shkollor i përshtatet qasjes që bazohet në kompetenca, përcaktuar në programin lëndor.					
15.5.1.2	Teksti shkollor ofron situata të nxëni të përshtatshme nga tri tematikat kryesore muzikore: <i>Gjuha dhe komunikimi muzikor, Teknika dhe procese muzikore dhe Historia, muzika dhe shoqëria.</i>					
15.5.1.3	Përmbajtjet muzikore të tekstit shkollor (shembujt për këndimin, zbatimin dhe dëgjimin e veprave muzikore) u përshtaten nivelit përkatës shkollor dhe aftësive perceptuese e interpretuese të nxënësve.					
15.5.1.4	Përmbajtjet muzikore të tekstit shkollor zhvillojnë larminë e informacioneve mbi gjuhë muzikore, formacione të ndryshme vokale dhe orkestrale (ansambël, llojet e orkestrave etj.), forma muzikore dhe gjini muzikore (muzikë vokale - instrumentale, instrumentale).					
15.5.1.5	Teksti shkollor respekton llojet e trashëgimisë muzikore popullore nga trevat e Shqipërisë dhe nga gjinitë e ndryshme të krijimtarisë kombëtare, si p.sh., këngë, valle, melodi për instrumente popullore nga të gjitha trevat.					
15.5.1.6	Teksti respekton llojet dhe krijimtarinë botërore muzikore (popullore dhe artistike) të vendeve të ndryshme, për t'i edukuar dhe për t'i përgatitur nxënësit me kultura të ndryshme muzikore.					
15.5.1.7	Radhitja e njësive mësimore në tekstin shkollor, sipas tematikave, është në funksion të ndërtimit të kompetencave muzikore.					
15.5.1.8	Teksti shkollor përdor ilustrime të përshtatshme që lidhen me konceptet muzikore, vendndodhjen e instrumenteve dhe instrumentistit në orkestër apo këngëtarit në skenë.					
15.5.1.9	Teksti shkollor ofron udhëzime të qarta për nxënësit dhe mësuesin se si të trajtohet dukuria e caktuar muzikore, përmes situatave konkrete: dëgjimi, këndimi, biseda, krijimi etj.					

15.5.1.10	Teksti shkollor merr parasysh nivelin e nxënësve në klasën përkatëse për sasinë dhe nivelin e vështirësisë së situatave, kur paraqet koncepte muzikore.					
15.5.1.11	Teksti shkollor ndërlidh situatat muzikore me artet e tjera: artin pamor, letërsinë, filmin, dramën etj.					
15.5.1.12	Teksti shkollor përmban material muzikor të përshtatshëm për interpretim (këngë dhe përmbajtje për lojë në instrumentet për fëmijë), në përputhje me kompetencat muzikore të nxënësve.					
15.5.1.13	Teksti shkollor orienton nxënësit për punë krijuese të pavarur.					
15.5.1.14	Teksti shkollor përmban këngë, tekstet e të cilave janë me vlerë të lartë edukative dhe letrare. Teksti i shqipëruar i këngëve të huaja ruan vlerat estetike-letrare të poezisë origjinale.					
15.5.1.15	Teksti shkollor përmban shembuj muzikorë që ndihmojnë nxënësit: a) të kuptojnë koncepte muzikore si: lartësia dhe gjatësia e tingujve; b) të dëgjojnë veprat muzikore; c) të shprehen me lëvizje; d) të vallëzojnë etj.					
15.5.1.16	Teksti shkollor ofron informacion mbi instrumente të ndryshme muzikore, shoqëruar me pamjet e instrumentit dhe me shembuj të përshtatshëm për dëgjimin e muzikës dhe për ilustrimin e ngjyrës së tingullit të instrumentit të caktuar.					

Vlera e standardit 15.5.1 = {[15.5.1.1 + - + 15.5.1.16] : 16} = ____

15.5.2 Arti pamor

Qëllimet: Qëllimi i tekstit është zhvillimi i aftësive krijuese dhe komunikuese të nxënësve, si edhe formimi i mënyrës së tyre të perceptimit artistik të botës, duke përfshirë teknikat dhe etapat zhvillimore sipas didaktikës së lëndës. Natyra e kësaj lënde kërkon zgjidhje të reja dhe qasje të larmishme për nxitjen e veprimtarisë krijuese të çdo nxënësi, duke i angazhuar ata në diskutim, përshkrim, analizë dhe vlerësim të veprave të artit shqiptar dhe botëror, të elementeve të kulturës, si edhe të krijimeve të bashkëmoshatarëve. Këto veprimtari zhvillojnë punën në grup dhe edukojnë respektin për mendimin e tjetrit. Treguesit e mëposhtëm synojnë të frymëzojnë përdorimin e metodologjive dhe teknikave krijuese që sigurojnë një tekst shkollor të suksesshëm, ku interesi dhe përkushtimi i nxënësve sjellin rezultate të qëndrueshme në edukimin e tyre artistik, kulturor dhe qytetar.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.5.2.1	Teksti shkollor i përshtatet nivelit arsimor dhe qasjes që përcakton programi lëndor.					
15.5.2.2	Teksti shkollor ofron situata të nxëni të përshtatshme për zhvillimin e tri tematikave kryesore: Gjuha dhe komunikimi artistik, Teknika e procese artistike dhe Historia, arti dhe					

	shoqëria.					
15.5.2.3	Teksti shkollor ka ilustrime origjinale të nivelit të lartë, fotografi, prodhime apo riprodhime (të veprave të autorëve), sipas nivelit të nxënësve dhe klasës.					
15.5.2.4	Teksti shkollor ka njësi mësimore që, përmes situatave me përmbajtje shkencore të kuptueshme (shembuj, ushtrime dhe formulime praktike), shërbejnë për ndërtimin sistematik të njohurive të reja dhe të kompetencave specifike lëndore.					
15.5.2.5	Mënyra e paraqitjes së situatave të nxënies dhe e ilustrimeve grafike në tekstin shkollor nxit nxënësit për krijim, nëpërmjet përdorimit të teknikave artistike.					
15.5.2.6	Teksti shkollor përmban materiale figurative të qarta dhe të përshtatshme që i nxitin nxënësit të krijojnë, të analizojnë, të bashkëveprojnë, të komunikojnë, të përvetësojnë dhe të transferojnë njohuritë artistike te njëri-tjetri.					
15.5.2.7	Teksti shkollor përputhet me normat e gjuhës letrare dhe pamore artistike, si dhe përmban përshkrime/udhëzime mbi gjuhën artistike, teknikat artistike dhe veprat shqiptare dhe botërore.					
15.5.2.8	Teksti shkollor pasqyron realitetin artistik dhe aspektet historike dhe kulturore të Shqipërisë me vepra të artit dhe me objekte të trashëgimisë kulturore.					
15.5.2.9	Teksti shkollor i shërben formimit të personalitetit krijues të nxënësve, nëpërmjet dijeve për teknikat e larmishme artistike, për gjuhën artistike, për veprat dhe për autorët, për kulturën, për zejet dhe artizanatin.					
15.5.2.10	Teksti shkollor i orienton nxënësit të njohin, të pranojnë dhe të zhvillojnë tolerancën ndaj kulturave të ndryshme, përmes kërkimeve, analizimit të veprave artistike dhe shkëmbimit të përvojave artistike.					
15.5.2.11	Teksti shkollor baraspeshon përmbajtjet, shembujt dhe ilustrimet, për të shmangur diskriminimin edhe në aspektin e përfaqësimit të autorëve me veprat e përfshira në tekst.					
15.5.2.12	Teksti shkollor përmban ide për kërkim, rubrika me punime praktike, pyetje dhe detyra tërheqëse, që nxënësit të vazhdojnë plotësimin e tyre në mënyrë të pavarur dhe të sigurt.					
15.5.2.13	Teksti shkollor udhëzon, nxit dhe plotëson përvetësimin e kompetencave artistike, përmes motivimit për krijime që zhvillojnë individualitetin krijues të nxënësve.					
15.5.2.14	Në tekstin shkollor paraqiten forma, teknika dhe mënyra të punës praktike që sqarojnë hollësisht fazat kërkimore-hulumtuese dhe mundësitë e shumta shprehëse dhe artistike.					
15.5.2.15	Teksti shkollor përmban informacione shtesë për zhvillimin e					

	artit, përmes teknologjisë.					
--	-----------------------------	--	--	--	--	--

Vlera e standardit 15.5.2 = {[15.5.2.1 + - + 15.5.2.15] :15} = _____

15.5.3 Teatri (AML)

Qëllimet: Teksti shkollor të përmbajë njohuri themelore të teatrit, duke qenë udhërrëfyes për mësuesin e teatrit në realizimin e qëllimeve të lëndës. Teksti shkollor të jetë mjet i nevojshëm për punë individuale, punë në grup dhe punë të pavarur. Teksti shkollor të jetë i plotë dhe i përdorshëm nga të gjithë nxënësit.
Teksti shkollor të konceptohet në njësi mësimore, të cilat përmbajnë situata (elemente dhe kombinime të veprimtarive kryesore të aktrimit) që ndihmojnë nxënësin të zhvillojë kompetencat e fushës/lëndës.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.5.3.1	Teksti u përshtatet aftësive njohëse, njohurive të ndërtuara paraprakisht nga nxënësit, nevojave dhe interesave të nxënësit; pamja dhe paraqitja e tekstit shkollor përputhet me moshën e nxënësve.					
16.5.3.2	Teksti shkollor ofron situata të nxëni të përshtatshme nga tri tematikat kryesore artistike: <i>Gjuha dhe komunikimi teatror, Teknika dhe pjesët teatrorë, Historia, teatri dhe shoqëria</i> , në renditje logjike.					
16.5.3.3	Përmbajtjet artistike të tekstit shkollor (shembujt nga etyde dhe vepra dramaturgjike nga e thjeshta deri te më e ndërlikuara) u përshtaten nivelit dhe aftësive perceptuese e interpretuese të nxënësve.					
16.5.3.4	Përmbajtjet e tekstit shkollor zhvillojnë kompetencat lëndore.					
16.5.3.5	Teksti respekton krijimtarinë dramaturgjike shqiptare dhe botërore për t'i njohur dhe për t'i përgatitur nxënësit me kultura të ndryshme teatrorë.					
16.5.3.6	Radhitja e njësive mësimore në tekstin shkollor, sipas kombinimit të njohurive artistike të tematikave, është në funksion të ndërtimit të kompetencave artistike.					
16.5.3.7	Teksti shkollor përdor ilustrime të përshtatshme që lidhen me përmbajtjet dhe situatat e të nxënit.					
16.5.3.8	Teksti shkollor ofron udhëzime të qarta për nxënësit dhe mësuesin se si të trajtohen përmbajtje të caktuara.					
16.5.3.9	Teksti shkollor merr parasysh nivelin e nxënësve në klasën përkatëse për sasinë dhe nivelin e vështirësisë së përmbajtjeve dhe të kërkesave artistike për t'u realizuar.					
16.5.3.10	Teksti shkollor ndërlidh situatat dramaturgjike me artet e tjera: artin pamor, letërsinë, filmin, muzikën etj.					

16.5.3.11	Teksti shkollor orienton nxënësit për punë krijuese të pavarur.					
16.5.3.12	Teksti shkollor përmban vepra të ndryshme dramaturgjike që përcjellin mesazhe të qarta dhe formojnë nxënësit me aftësi interpretuese sipas zhanrit dhe rrethanave historike e shoqërore që kërkon vepra.					
16.5.3.13	Teksti shkollor përmban materiale që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë gjinitë artistike skenike, elementet teatrore të këtyre zhanreve, gjuhën artistike dhe lidhjen mes një materiali dhe interpretimit të tij, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të shprehin qartë qëndrimin e tyre ndaj një krijimi të caktuar artistik.					

Vlera e standardit 15.5.3 = {[15.5.3.1 + - + 15.5.3.13] :13} = _____

15.6. TEKNOLOGJI DHE TIK

15.6.1 Aftësimi teknologjik praktik

Qëllimet: *Tekstet shkollore të jenë bashkëkohore për nga përmbajtja, metodologjia e shtjellimit dhe qasja didaktike / pedagogjike. Ato të përmbajnë materiale, të dhëna dhe metoda të reja pune që të ndihmojnë nxënësit në përvetësimin e njohurive dhe të kompetencave për integrim në proceset globale ku përparimet teknologjike janë shtysë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik në veçanti.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.6.1.1	Teksti shkollor u përshtatet nivelit shkollor dhe qasjeve që përcakton kurrikula për këtë nivel.					
15.6.1.2	Në tekstin shkollor, përmbajtjet janë aktuale, të bazuara në arritjet më të reja të shkencave natyrore, veçanërisht të shkencave teknike dhe informatike. Idetë, konceptet, eksperimentet, shembujt dhe projektet e punimeve të dorës në tekstin shkollor janë të kapshme dhe të kuptueshme për grup-moshën e nxënësve.					
15.6.1.3	Situatat e paraqitura në tekst, veçanërisht punimet praktike, nxitin dhe zhvillojnë krijimtarinë individuale dhe aftësinë për punë në grup të nxënësve.					
15.6.1.4	Situatat e shtjelluara në tekstin shkollor janë renditur sipas shkallës së vështirësisë, duke filluar nga më të thjeshtat.					
15.6.1.5	Projektet e punës së dorës, eksperimentet dhe ushtrimet janë konceptuar dhe strukturuar në situata që zhvillojnë aftësinë e nxënësve për zbatimin në praktikë të njohurive dhe të kompetencave të ndërtuara.					
15.6.1.6	Përmes përshkallëzimit dhe llojshmërisë së punëve të dorës, teksti shkollor kultivon te nxënësi ndjenjën e efikasitetit të punës dhe të vetëbesimit për arritje të suksesshme.					
15.6.1.7	Ilustrimet janë të shumta, të sakta, të kuptueshme dhe respektojnë veçoritë e logjikës teknike. Ku është e nevojshme, ilustrimet kanë legjenda shpjeguese të kuptueshme dhe të dallueshme (me numra, shkronja apo ngjyra të ndryshme).					
15.6.1.8	Teksti shkollor u kushton kujdesin e duhur emërtimeve tekniko-teknologjike bashkëkohore, duke baraspeshuar emërtimet dhe shkurtime teknike në gjuhën origjinale dhe përkthimin e tyre në gjuhën shqipe.					
15.6.1.9	Në tekstin shkollor u kushtohet kujdes i veçantë aspekteve të edukimit shëndetësor.					
15.6.1.10	Ushtrimet dhe punimet praktike zhvillojnë te nxënësit ndjenjën për kursim të materialeve që përdoren.					

15.6.1.11	Në tekstin shkollor i kushtohet vëmendje e veçantë mjedisit, duke e trajtuar shkencërisht. Ndotja lokale dhe globale e mjedisit shtjellohet përmes lidhjes shkak-pasojë të veprimeve të njeriut.					
15.6.1.12	Teksti shkollor përmban teste për vetëvlerësim që janë tërheqëse, gjithëpërfshirëse, të kuptueshme dhe të përdorshme nga nxënësi.					

Vlera e standardit 15.6.1 = {[15.6.1.1 + - + 15.6.1.12] :12} = _____

15.6.2 TIK

Qëllimet: *Tekstet shkollore të TIK-ut të shërbejnë si mbështetje për zhvillimin e kompetencave digjitale të nxënësve dhe për përdorimin e teknologjisë si mjet për të nxënë, për të komunikuar, për të krijuar dhe për të bashkëpunuar. Ato duhet të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë rolin e teknologjisë në jetën personale, shkollore dhe shoqërore, duke i pajisur me njohuri, aftësi dhe qëndrime që i ndihmojnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe etike në mjedisin digjital. Tekstet duhet të kontribuojnë në zhvillimin e të menduarit kompjuterik, kritik, krijues dhe logjik përmes situatave konkrete të përdorimit të TIK-ut, si dhe në aftësimin e nxënësve për të kërkuar, përzgjedhur, vlerësuar dhe përdorur informacionin në mënyrë efektive. Ato të mbështesin zhvillimin e qytetarisë digjitale, sigurisë në internet dhe përdorimit të qëndrueshëm të teknologjisë, duke nxitur përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.6.2.1	Teksti shkollor përputhet me filozofinë, qëllimet dhe kompetencat e programit mësimor të TIK-ut, duke siguruar një lidhje të qartë ndërmjet përmbajtjes, rezultateve të të nxënës dhe zhvillimit të aftësive digjitale.					
15.6.2.2	Teksti përmban aparat pedagogjik me kërkesa të përcaktuara që u drejtohen nxënësve në funksion të përmbushjes së rezultateve të të nxënës, për çdo njësi mësimore dhe nivel të nxënë.					
15.6.2.3	Teksti shkollor u referohet risive teknologjike dhe u përgjigjet nevojave të nxënësve për përdorimin e TIK-ut.					
15.6.2.4	Struktura e ndërtimit të tekstit është e qartë, logjike dhe lehtë në përdorim, duke lejuar orientim të shpejtë dhe të kuptueshëm për nxënësin.					
15.6.2.5	Ngarkesa e njësive mësimore është e balancuar, në përputhje me moshën dhe mundëson progres të vazhdueshëm në përdorimin e teknologjisë.					
15.6.2.6	Teksti shkollor nxit zhvillimin e kompetencave digjitale përmes situatave konkrete të të nxënës që lidhen me përdorimin praktik të teknologjisë, zgjidhjen e problemeve dhe krijimin e produkteve digjitale.					
15.6.2.7	Teksti shkollor ndihmon nxënësit të zhvillojnë të menduarin					

	kompjuterik, logjik, kritik dhe krijues përmes detyrave, ushtrimeve dhe aktiviteteve që kërkojnë analizë, krahasim dhe bashkëpunim.					
15.6.2.8	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar dhe për mësim individual, duke ofruar detyra me nivele të ndryshme vështirësie, të përshtatura sipas aftësive të nxënësve.					
15.6.2.9	Teksti shkollor përmban, në sasi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, situata tërheqëse e motivuese, në të cilat nxënësit ndërtojnë dhe demonstrojnë aftësitë në TIK-ut.					
15.6.2.10	Teksti shkollor promovon qytetarinë digjitale, sigurinë në internet dhe respektimin e të drejtave të autorit, si pjesë e formimit të një kulture të qëndrueshme digjitale.					
15.6.2.11	Teksti shkollor përmban udhëzime të qarta për përdorimin e programeve dhe aplikacioneve kompjuterike.					
15.6.2.12	Teksti shkollor krijon lidhje harmonike ndërmjet përmbajtjes teorike dhe veprimtarive praktike, duke integruar përdorimin e mjeteve digjitale, aplikacioneve dhe burimeve online.					
15.6.2.13	Përmbajtja vizuale është e qartë, e lexueshme, me ngjyra të balancuara dhe dizajn që mbështet të nxënësit aktiv.					
15.6.2.14	Teksti shkollor përfshin ilustrime, figura dhe screenshots të qarta për të shoqëruar shpjegimet e komandave, programeve dhe koncepteve të TIK-ut, pamjet, grafikët dhe ilustrimet kanë rezolucion të mjaftueshëm, kontrast të përshtatshëm dhe mbishkrime të lexueshme.					
15.6.2.15	Në tekstin shkollor të TIK-ut, përmbajtja, simbolet, ikonat dhe paraqitjet grafike janë në përputhje me standardet ndërkombëtare ISO/IEC dhe IEEE , si dhe me praktikën bashkëkohore të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.					
15.6.2.16	Teksti shkollor zhvillon lidhje ndërmjet TIK-ut dhe fushave të tjera të të nxënësit, duke promovuar qasje ndërkurrikulare me gjuhët dhe komunikimin, shkencat e natyrës, matematikën, artet dhe shkencat shoqërore.					
15.6.2.17	Teksti shkollor ofron strategji dhe instrumente për vlerësimin e arritjeve dhe vetëvlerësimin e nxënësve, përmes detyrave praktike, reflektimeve dhe ushtrimeve/projekteve të vogla digjitale.					
15.6.2.18	Gjuha e përdorur është e qartë, e saktë dhe e përshtatur me moshën dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve, duke shpjeguar në mënyrë të kuptueshme terminologjinë shkencore të TIK-ut.					

Vlera e standardit 15.6.2 = {[15.6.2.1 + - + 15.6.2.18] :18} = _____

15.6.3 Bazat e inxhinierisë dhe Teknologjia (AML)

Qëllimet: *Tekstet shkollore të luajnë rolin e mjetit ndihmës dhe të kontribuojnë në zhvillimin e njohurive dhe të kompetencave (veçanërisht, atë digjitale), në aspekte të ndryshme të profesionit. Ato të ndihmojnë nxënësit të çmojnë vlerat dhe potencialet e tyre, për t'u orientuar drejt karrierës profesionale dhe për të marrë përgjegjësi në zhvillimin e vazhdueshëm personal dhe profesional; të mbështetin nxënësit për të bashkëpunuar dhe për besim të ndërsjellë, nëpërmjet punës praktike; të jenë burim i njohurive për zhvillimin perspektiv të profesionit, në kontekstet e integritetit rajonal dhe evropian. Teksti shkollor të përmbajë njohuritë dhe proceset më të reja teknologjike në sektorin e profesionit përkatës. Teksti shkollor të përmbajë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.*

Këtyre qëllimeve t'u shërbejnë udhëzimet në lidhje me strategjitë e të nxënës, përgatitja, hartimi dhe paraqitja e lëndës, të cilat mbështetin të nxënës në mënyrë vepruese, aktive dhe motivuese.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.6.3.1	Teksti shkollor u përshtatet nivelit shkollor dhe qasjeve që përcakton kurrikula për këtë nivel arsimor.					
15.6.3.2	Teksti shkollor ofron situata të nxëni (materiale, sugjerime, prova, detyra) për secilin nivel të njohjes që ndihmojnë ndërtimin dhe zbatimin e njohurive të reja dhe të kompetencave.					
15.6.3.3	Format, mënyrat dhe ecuritë e paraqitjes së ligjshmërive në tekstin shkollor janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
15.6.3.4	Teksti shkollor u referohet risive tekniko-teknologjike dhe nevojave që ka tregu i punës për përdorimin e TIK-ut në çdo fushë.					
15.6.3.5	Teksti shkollor ofron situata të nxëni (materiale, sugjerime, prova, detyra, eksperimente) për secilin nivel të njohjes që ndihmojnë ndërtimin dhe zbatimin e njohurive të reja dhe të kompetencave.					
15.6.3.6	Teksti shkollor përfshin ilustrime, figura dhe screenshots të qarta për të shoqëruar shpjegimet e komandave dhe programeve teknologjike.					
15.6.3.7	Kuptimi i ligjshmërive në tekstin shkollor bazohet në arritjet e reja shkencore tekniko-teknologjike dhe në hulumtimet në laboratorë, në industri dhe në institucione kërkimore shkencore që i nxitin nxënësit të hulumtojnë dhe të nxënë të reja shkencore.					
15.6.3.8	Në tekstin shkollor, detyrat, provat, demonstrimet, vëzhgimet u referohen zhvillimit të njohurive dhe të kompetencave, në pajtim me zhvillimin tekniko-teknologjik dhe mundësojnë					

	integrimin e nxënësve në tregun e punës.					
15.6.3.9	Teksti shkollor u ofron nxënësve probleme, metoda zbatimi (matematikore, kimike, fizike etj.), zgjidhje interesante, tërheqëse, por dhe mundësi e sugjerime për të nxënit në mënyrë hulumtuese dhe të pavarur.					
15.6.3.10	Teksti shkollor, përmes rezultateve eksperimentale, vëzhgimeve në terren /laborator dhe detyrave tipike u ofron nxënësve mundësinë e të nxënit në grup ose të pavarur, në përputhje me moshën e tyre.					
15.6.3.11	Detyrat, sugjerimet për punë të pavarur, ushtrimet, provat, demonstrimet në tekstin shkollor janë hartuar për të nxitur motivimin, komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve.					
15.6.3.12	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar me nxënësit dhe për punë të pavarur, sepse ofron, detyra, ushtrime, prova, demonstrime dhe vëzhgime të niveleve të ndryshme, sipas vështirësisë dhe kërkesave.					
15.6.3.13	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e edukimit shëndetësor dhe të ruajtjes së mjedisit.					
15.6.3.14	Në fund të tekstit shkollor, gjendet fjalori përmbledhës i termave kryesorë të trajtuar, si dhe treguesi i termave profesionalë.					
15.6.3.15	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e sigurimit teknik (varësisht profilit profesional).					
15.6.3.16	Në tekstin shkollor, korniza e përmbajtjes, e simboleve dhe e formulave, si dhe emërtimi i tyre është në përputhje me sistemin ndërkombëtar ISO (të njësive në "Sistemi SI"; IEC 60027; me standardet ndërkombëtare dhe me standardet e reja (aktuale) të profesionit, me rregullat e IUPAC-ut etj.					
15.6.3.17	Teksti shkollor u ofron nxënësve teknika dhe mënyra për vlerësim ose vetëvlerësim.					

Vlera e standardit 15.6.3 = {[15.6.3.1 + - + 15.6.3.17] :17} = _____

STANDARDET E PËRMBAJTJES DIGJITALE

Përmbajtja digjitale është çdo material mësimor që krijohet, shpërndahet ose përdoret në format elektronik, përmes platformave ose pajisjeve digjitale. Ajo përfshin tekste, imazhe, audio, video, animacione, simulime ndërvepruese dhe aktivitete të integruara, të strukturuar për të mbështetur procesin e të nxënës.

Përmbajtja digjitale duhet të jetë në përputhje me tekstin shkollor i cili shpallet fitues në renditjen paraprake të teksteve të reja shkollore.

Përmbajtja digjitale duhet të jetë e aksesueshme, ndërvepruese dhe e përshtatshme për nivelet e ndryshme të nxënësve, duke mundësuar personalizimin, punën në grup, vetëzhvillimin dhe vlerësimin formues.

Kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përmbajtjes digjitale janë të njëjta me ato teksteve shkollore fizike.

Standardi 1: Funksionet dhe cilësia e përmbajtjes digjitale

Qëllimet: *Përmbajtja digjitale që shoqëron tekstin shkollor të garantojë funksionim teknik të qëndrueshëm, akses të plotë dhe përdorim të lehtë për të gjithë nxënësit dhe mësuesit. Ajo duhet të jetë e përditësueshme, fleksibël, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të ofrojë elemente multimediale që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore. Përmbajtja digjitale të ndihmojë dhe të nxisë përvetësimin, zbatimin dhe transferimin e njohurive dhe të kompetencave.*

Përmbajtja digjitale të jetë e larmishme, motivuese dhe gjithëpërfshirëse, të përshtatet me nivele të ndryshme të aftësive dhe stileve të të nxënës, duke mbështetur edhe nxënësit me nevojë të veçanta dhe duke respektuar parimet e Dizajnit Universal për të Nxënës (UDL). Ajo duhet të ndihmojë mësuesin dhe nxënësit për zbatimin e qasjes së bazuar në kompetenca dhe të mundësojë mësim aktiv, bashkëpunues dhe krijues.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1.	Përmbajtja digjitale lidhet plotësisht me përmbajtjen e tekstit shkollor, ndjek rrjedhën e tij logjike, si dhe e mbështet dhe e plotëson atë.					
1.2.	Materialet në përmbajtjen digjitale janë të organizuara në mënyrë të qartë sipas kapitujve/temave dhe përmbajnë përshkrimin e mësimeve dhe aktiviteteve, si dhe vlerësimin e kohës së nevojshme për realizimin e tyre.					
1.3.	Përmbajtja digjitale përmban elemente që shërbejnë për përpunimin, përvetësimin, zbatimin dhe transferimin e njohurive dhe të kompetencave të fituara.					
1.4.	Përmbajtja digjitale përfshin materiale dhe aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e të nxënës të lëndës.					
1.5.	Përmbajtja digjitale përmban ushtrime, simulime, teste dhe vetëvlerësime.					
1.6.	Përmbajtja digjitale mundëson ndërveprimin mësues-nxënës dhe					

	nxënës- nxënës.					
1.7.	Përmbajtja digjitale përmban elementë multimedialë (video, audio, animacione, simulime, IA etj.) që mbështesin mësimdhënien dhe funksionojnë me ose pa internet.					
1.8.	Platforma digjitale është e sigurt dhe nuk mbledh të dhëna të panevojshme, në përputhje me kriteret e privatësisë.					
1.9.	Përmbajtja digjitale përdoret si në mësimin në klasë, ashtu edhe në distancë, në mënyrë individuale ose në grup.					
1.10.	Përmbajtja digjitale funksionon plotësisht me pajisjet digjitale që përdorin institucionet arsimore (p.sh., në Smart Lab).					
1.11.	Përmbajtja digjitale është e aksesueshme pa ndërprerje gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë.					
1.12.	Përmbajtja digjitale është e lehtë për t'u përdorur nga të gjithë nxënësit, duke respektuar parimet e gjithëpërfshirjes.					
1.13.	Përmbajtja digjitale mundëson përditësimin teknik dhe përmbajtjesor pa penguar përdorimin e saj.					
1.14.	Përmbajtja digjitale është e pavarur nga pajisja ose sistemi operativ (platformë e hapur dhe e transferueshme).					
1.15.	Përmbajtja digjitale është e ripërdorshme dhe e përshtatshme për kontekste të tjera mësimore.					
1.16.	Përmbajtja digjitale shoqërohet me një udhëzues për përdorimin pedagogjik dhe teknik nga mësuesit dhe nga nxënësit.					

Vlera e standardit 1 = {[1.1 + - + 1.16] :16} = _____

Standardi 2: Aspektet gjuhësore të përmbajtjes digjitale

Qëllimet: *Gjuha e përmbajtjes digjitale të jetë në përputhje me normat e gjuhës standarde. Gjuha e përmbajtjes digjitale t'u shërbejë nxënësve për formimin e kompetencave kyç, në veçanti të kompetencës së komunikimit në gjuhën amtare. Nëpërmjet gjuhës së përmbajtjes digjitale, nxënësi të përkushtohet dhe të kontribuojë për bashkëbisedim konstruktiv, të respektojë rregullat e komunikimit, të shprehë tolerancë dhe empati (ndjeshmëri) në komunikim. Nga ana leksikore dhe sintaksore, gjatësia e shkrimeve mësimore (për temë mësimore), duhet t'u përshtatet moshës dhe aftësive gjuhësore të moshës për të cilën përmbajtja digjitale është përgatitur. Formulimet, sidomos të udhëzimeve, të pyetjeve dhe të detyrave, të jenë të kuptueshme dhe të thjeshta, që të nxitet mësimi i pavarur. Përmbajtja digjitale të ofrojë edhe materiale për nxënësit me nevojë të veçanta, në mënyrë që të mbështetet gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja aktive e tyre.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
2.1.	Leksiku dhe fjalori i përdorur në përmbajtjen digjitale është i përshtatshëm për moshën e nxënësve.					

2.2.	Ndërtimi sintaksor dhe struktura gjuhësore e <i>përmbajtjes digjitale</i> përputhen me mundësitë dhe aftësitë gjuhësore të nxënësve.					
2.3.	Gjatësia e teksteve dhe e shkrimeve është në përshtatje me moshën e nxënësve.					
2.4.	Formulimet, sidomos të detyrave dhe të udhëzimeve për punë të pavarur, janë të kuptueshme dhe të thjeshta, që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.					
2.5.	Gjuha e përmbajtjes digjitale, në aspektet morfologjike, sintaksore dhe drejtshkrimore, përputhet plotësisht me normat e standardit të gjuhës.					
2.6.	Përmbajtja digjitale përfshin edhe shkrime dhe materiale të përshtatura posaçërisht për nxënësit me nevoja të veçanta, me fjalor të qartë, struktura të thjeshta dhe shpjegime ndihmëse që lehtësojnë kuptimin, si dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin mësimor.					

Vlera e standardit 2 = {[2.1 + - + 2.6] :6} = _____

SHTOJCA:**SHTOJCA 1: STANDARDI PËR PËRPUTHJEN E TEKSTIT SHKOLLOR ME KUADRIN LIGJOR DHE ETIK**

Titulli i tekstit:	Kodi
Klasa:	Data e vlerësimit:

Nr.	Treguesit	PO	JO
1.	Elemente të tekstit shkollor bien ndesh me Kushtetutën e Shqipërisë, Ligjin për arsimin parauniversitar dhe Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.		
2.	Në tekstin shkollor konstatohen pohime ose ilustrime bien në kundërshtim me kodin e etikës së shoqërisë.		
3.	Në tekstin shkollor konstatohen paragjykime sociale, etnike, racore, fetare, moshore, gjinore, gjeografike, si dhe elemente të frymës së urrejtjes dhe të nxitjes së armiqësisë për popujt e tjerë.		
4.	Teksti shkollor përmban reklama / promocione.		
5.	Teksti përdor materiale (tekste, ilustrime, foto) pa respektuar të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale, si dhe të papërditësuara me zhvillimet bashkëkohore.		
6.	Teksti shkollor përmban elemente që mund të identifikojnë përkatësinë e shtëpisë botuese dhe të autorëve.		

Argumentimi i vlerësimit:

Emri dhe mbiemri i vlerësuesit _____

Nënshkrimi i vlerësuesit _____

SHTOJCA 2: FORMATI I FORMULARIT PËRMBLEDHËS

Titulli i tekstit:	Kodi
Klasa:	Data e vlerësimit:

Standardet		Vlera
STANDARDE TË PËRGJITHSHME		
Përputhshmëria me kurrikulën, formatimi, paraqitja (standardet 1 – 3)		
1	Përputhshmëria me kurrikulën dhe me tekstet shkollore të klasave pararendëse dhe pasuese të së njëjtës lëndë	
2	Kompozimi/projektimi grafik, faqosja e tekstit	
3	Ilustrimet	
Çështje shkencore dhe didaktike (standardet 4-8)		
4	Cilësia në lidhje me përmbajtjen e lëndës, rëndësinë dhe aktualitetin	
5	Përshtatja me moshën dhe me nevojat e nxënësve	
6	Konceptimi dhe shtjellimet didaktike	
7	Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat	
8	Aspektet gjuhësore	
Çështje pedagogjike (standardet 9-12)		
9	Lidhjet me realitetet politike, historike dhe shoqërore	
10	Çështjet edukative, pavarësia, edukimi për demokraci dhe paqe	
11	Pasqyrimi i barazisë gjinore në tekstin shkollor	
12	Integrimi ndërlëndor dhe i temave ndërkurrikulare	
Çështje që lidhen me praktikën pedagogjike (standardet 13-14)		
13	Teksti/udhëzuesi i mësuesit dhe përdorimi i tij	
14	Materialet që shoqërojnë tekstin shkollor	
VLERA E STANDARDIT LËNDOR		
15	Standardi lëndor	
VLERA E TEKSTIT		

Komentet përfundimtare (në fletë shtesë)

Emri dhe mbiemri i vlerësuesit _____

Nënshkrimi i vlerësuesit _____

SHTOJCA 3: FORMULARI PËR PLOTËSIMIN E STANDARDIT TEKNIK TË TEKSTIT SHKOLLOR

Titulli i tekstit:	
Klasa:	Data e vlerësimit:

Nr.	ELEMENTET E TEKSTIT SHKOLLOR	KRITERET	PO	JO
1	Organizimi i përmbajtjes së tekstit shkollor	Përmbajtja e tekstit shkollor paraqitet në një vëllim.		
2	Formati i prerë i tekstit shkollor	Klasat I – V: 207 mm gjatësi x 277 mm gjerësi Klasat VI –XII: 180 mm gjatësi x 250 mm gjerësi		
3	Madhësia e germave	Klasat I-II: Shkronja me font mbi 14 Klasat III – IX: Shkronja me font mbi 12 Klasat X-XII: Shkronja me font mbi 11		
5	Hapësira mes rreshtave	Hapësira mes rreshtave: 120% e shkronjave		
6	Lloji i letrës për bllokun e librit dhe të fletores së punës (nëse ka)	Asnjë lloj letre me lustër Opaciteti 80 për qind (ISO 2471) Shkëlqimi 83 për qind (ISO 2470) Pesha e letrës së librit 70 gsm Pesha e letrës së fletores së punës (nëse ka) 70 gsm		
7	Lloji i letrës për kopertinën	Për libra deri 96 faqe 200 gsm Për libra mbi 96 faqe 280 gsm		
8	Ngjyrat për bllokun e librit / të fletë punëve Ngjyra për kopertinat	Libri i nxënësit 4 ngjyra Fletore pune e detyrueshme 2 ngjyra Kopertinat 4 ngjyra		
9	Lloji i lidhjes	Deri 96 faqe Me tel kaluar; 2 kapje Mbi 96 faqe Ngjitje me hotmelt		
10	Elemente të detyrueshme të kopertinave	ISBN-ja Barkod-i Çmimi Logo-ja e botuesit		
11	Qëndrueshmëria e tekstit shkollor	Cilësia e materialeve të përdorura për shtypjen e tekstit, përfshirë llojin e letrës, llojin e lidhjes së fletëve dhe mbrojtjen e kopertinës, është e tillë që garanton që libri të qëndrojë i paprekur dhe funksional gjatë gjithë vitit shkollor, edhe me përdorim të shpeshtë nga nxënësit.		

Vlerësimi (në fletë shtesë)

Emri dhe mbiemri i vlerësuesit _____

Nënshkrimi i vlerësuesit _____

BIBLIOGRAFIA

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2013). *Paketa "Altertekst 2013"*.
2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2011). *Standardet për tekstet shkollore*.
https://www.masht.gov.net/advCms/documents/standardet_e_teksteve.pdf
3. Ministry of Foreign Affairs of Japan. (2014). *How a textbook becomes part of a school curriculum*.
<https://www.mofa.go.jp/policy/education/textbooks/overview-1.html>
4. Ministère de l'Éducation, du Loisir et du Sport. (2014). *Instructional materials approved for secondary level*.
http://www.mels.gouv.qc.ca/bamd/doc/Liste_secondaire_ang_ref.pdf
5. Association of American Publishers. (2014). *Quality assurance process for instructional materials*.
<https://publishers.org/schoolquality/>
6. Huttová, J., & Nogová, M. (2005). Education and textbook systems in the Slovak Republic. In M. Horsley, V. S. Knudsen, & S. Selander (Eds.), *Has past passed? Textbooks and educational media for the 21st century* (Vol. 7). IARTEM.
<http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:179762/FULLTEXT01.pdf>
7. Pingel, F. (2010). *UNESCO guidebook on textbook research and textbook revision* (2nd rev. ed.). UNESCO.
8. Becker, G., et al. (2005). *Standards: Unterrichten zwischen Kompetenzen, zentralen Prüfungen und Vergleichsarbeiten* (Issue 23). Friedrich Jahresheft.
9. Council of Europe. (n.d.). *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment*.
https://www.coe.int/t/dg4/linguistic/source/framework_en.pdf
10. Exarhos, I. (2006). Greek primary teachers' preferences for and characteristics of science textbooks.
<http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:179762/FULLTEXT01.pdf#page=218>
11. Georgescu, D., & Bernard, J. (2007). *Thinking and building peace through innovative textbook design*. UNESCO.
<https://unesdoc.unesco.org/images/0016/001612/161254e.pdf>
12. Ministarstvo prosvjete i sporta Republike Hrvatske. (2003). *Udžbenički standard*. Zagreb.
13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë. (2006). *Koncepcioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*. Manastir: SHA "Kiro Dandaro".

14. Nogová, M., & Huttová, J. (2006). *Process of development and testing on textbook evaluation criteria in Slovakia*.
http://www.ef.jcu.cz/~cincurov/PhD/Zkou%C5%A1ky/Hospesova-XTVM/nogova_huttova.pdf
15. Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Shqipërisë. (2006). *Urdhër për krijimin e bordit të miratimit të teksteve shkollore* (Nr. 108, datë 28.03.2006).
16. Georg Eckert Institute. (n.d.). *The institute*. <https://www.gei.de/en/the-institute.html>
17. UNESCO International Bureau of Education. (n.d.). *UNESCO IBE*.
<https://www.ibe.unesco.org/en>
18. European Commission. (n.d.). *Erasmus+*. https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/index_en.htm
19. Wikibooks. (n.d.). *Textbook standards*.
https://en.wikibooks.org/wiki/Wikibooks:Textbook_Standards
20. UNESCO. (2017). *Guidelines for textbook development and revision*. UNESCO.
21. UNESCO. (2016). *Global Education Monitoring Report 2016: The role of textbooks in education*. UNESCO Publishing.
22. https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/UDHEZIM-NR.26.DT_17.11.2025-Final.pdf